


Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

**Raporti për
Shqipërinë 2023**



Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për Shqipërinë 2023

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Shtator, 2024



**Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian**



Botuesi : Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Autorwt : Kostandina Këruti

Klotilda Kosta

Juliana Hoxha

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Adresa: Macedonia Street 43-1/9, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

Telefon: +389 2 6144 211

Email: executiveoffice@balkanccd.net

Website: www.balkanccd.net

www.monitoringmatrix.net

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Adresa: Elbasan Street, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73, Tirana

Telefon: 00355 4 2254 881

Email: parters@partnersalbania.org

nfo@resourcecentre.al

Faqja e internetit: www.partnersalbania.org

www.resourcecentre.al

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Tiranë, Shqipëri 2024.

Një version elektronik është i disponueshëm në faqen e internetit të Partnerëve Shqipëri www.partnersalbania.org, në faqen e Qendrës Kombëtare Burimore www.resourcecentre.al, në faqen e BCSDN: www.balkanccd.net si dhe në faqen: <http://www.monitoringmatrix.net>

Ky raport është pjesë e “Western Balkan Civil Society Development Hub” financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, (Sida), dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, në bashkëpunim me anëtarët e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe pjesë e aktiviteteve të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe pozicionin zyrtar dhe opinionin e Sida.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	7
Mirënjohje	8
Përmbledhje ekzekutive	10
Pasqyrë e shoqërisë civile	10
Gjetjet kryesore	11
Rekomandimet kryesore	12
Gjetjet	13
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive	13
1.1. Liria e organizimit.....	13
1.2. Liritë e tjera	20
Fusha 2: Kuadri për Qendrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OJF-të	25
2.1. Trajtimi tatimor/ fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre	25
2.2. Mbështetja e shtetit.....	29
2.3. Kapitali njerëzor	36
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet-OJF	39
3.1. Korniza dhe praktikrat për bashkëpunim	39
3.2. Përfshirja në procesin e politikave dhe vendimmarrjes.....	42
3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve	47
Bibliografia	49
Anekset	53
Shënime mbi Metodologjinë	53

Shkurtime

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
BCSDN	Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
CoE	Këshilli i Evropës
OJF	Organizata Jofitimprurëse
BE	Bashkimi Evropian
VF	Viti Fiskal
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
PPIE	Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
MD	Ministria e Drejtësisë
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KKShC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
NRC	Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
MM	Matrica e Monitorimit
PA	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
DRT	Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Hyrje

Partneret Shqiperi për Ndryshim dhe Zhvillim ka kënaqësinë të prezantojë edicionin e dhjetë të *Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile -Raporti për Shqipërinë 2023*, që mbulon zhvillimet në Shqipëri për vitin 2023.

Ky raport është pjesë e një serie raportesh të vendeve që mbulojnë gjashtë vende në Ballkanin Perëndimor: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, dhe Serbinë. Një raport rajonal është gjithashtu i disponueshëm që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për të gjitha vendet dhe një platformë interaktive interneti, që ofron akses në të dhënat e monitorimit për çdo vend në www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit, e zhvilluar në vitin 2013 nga BCSDN-ja me mbështetjen e anëtarëve dhe partnerëve të saj, paraqet parimet dhe standardet kryesore që janë identifikuar si thelbësore për ekzistencën e mjedisit për tu konsideruar mundësues për veprimtarinë e OJF-ve. Matrica është e organizuar rreth tre zonave, secila e ndarë sipas nën zonave:

- Garancitë ligjore themelore të lirive.
- Korniza për qëndrueshmërinë financiare dhe qëndrueshmërinë e OJF-ve;
- Marrëdhëniet Qeveri -OJF

Metodologjia gjithëpërfshirëse bazohet në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira rregullatore në nivel të Bashkimit Evropian dhe në vendet Europiane. Matrica synon të përcaktojë kushtet optimale për funksionimin dhe zhvillimin efektiv të shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë, ajo synon të përcaktojë një kornizë realiste që mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë në zbatimin mbi 150 tregues janë vendosur për të monitoruar si kuadrin ligjor ekzistues ashtu dhe zbatimin praktik të tij.

Matrica e Monitorimit funksionon mbi bazën e një cikli raportimi vjetor, i cili siguron një vlerësim sistematik dhe të krahasueshëm në të gjithë rajonin dhe ndër vite. Ky proces ndihmon palët e interesit të vlerësojnë progresin ose regresin, identifikojë nevoat për përmirësim dhe tendecat në zhvillim, si dhe tu jap përparësi reformave. Hulumtimi i kryer synon të sigurojë një raportim mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile dhe të influencojë Politikën e zgjerimit të BE-së dhe mbështetjen e financimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit.

Mirënjohje

“Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2023” është përgatitur nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, me përpjekje bashkëpunuese dhe mbështetje nga shumë organizata jofitimprurëse (OJO) në mbarë Shqipërinë. Ky raport ofron një vlerësim të gjithanshëm të gjendjes aktuale të mjedisit mundësues për shoqërinë civile në Shqipëri, duke reflektuar kontributet kolektive nga një gamë e gjerë aktorësh.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim shpreh mirënjohjen e saj për drejtorët ekzekutivë dhe menaxherët e lartë të OJF-ve pjesëmarrëse, bashkëpunimi dhe perspektivat e vlefshme të të cilëve bënë të mundur përgatitjen e këtij raporti. Pjesëmarrja e tyre në vëzhgim dhe intervistat e thelluara, që përfshinë 121 OJF, nxorri në pah sfidat dhe mundësitë brenda sektorit.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim falënderon gjithashtu institucionet publike që iu përgjigjën kërkesave për informacion, duke ofruar të dhëna dhe njohuri thelbësore që ndihmuan në analizë.

Përmbledhje ekzekutive

Pasqyrë e shoqërisë civile

	2022	2023
Numri i organizatave të regjistruara	12,515 OJF 275 OJF të reja të regjistruara	12,768 OJF 253 OJF të reja të regjistruara
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	Kodi Civil i Shqipërisë Ligji Nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”. Ligji Nr. 8989/2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” Ligji Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”	
Ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor	Ligji Nr. 6/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 112/2020 “Per regjistrin e pronarëve përfituesr” Ligji Nr. 82/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 92/2014 për TVSH -në”, i ndryshuar Ligji Nr. 83/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar.	Udhëzimi Nr. 11, datë 13.04.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 6 , datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar Ligji Nr. 78/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligjit Nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit“, i përditësuar
Financimi shtetëror	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile: 95 milionë Lekë (përafërsisht 795,000 Euro).	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile: 98 milionë Lekë (përafërsisht 980,000 Euro)
Burimet njerëzore (punonjës dhe vullnetarë)	11,972 punonjës Nuk ka të dhëna për numrin e vullnetarëve	10.917 punonjës, nga të cilët 9,748 punonjës me kohë të plotë dhe 1,169 punonjës me kohë të pjesshme Nuk ka të dhëna për numrin e vullnetarëve
Bashkëpunimi OJF-Qeveri (organi përkatës/mekanizmi konsultativ)	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian	
Sfidat kryesore	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave të unifikuar dhe të sakta për OJF-të. • Bashkëpunimi efektiv OJF -Qeveri mbetet i ulët 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave të unifikuar dhe të sakta për OJF-të • Procedurat joefektive të TVSH -së për financimin e huaj.

Gjetjet kryesore

1	<p>Regjistri elektronik i planifikuar të ishte funksional më 30 dhjetor 2023, sipas Ligjit Nr. 80/2021 dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ende nuk është funksional. Vonesa në krijimin e regjistrit të OJF-ve është bërë një pengesë e konsiderueshme për funksionimin e OJF-ve , pasi proceset specifike të sektorit varen nga ky regjistër.</p>
2	<p>Hyrja në fuqi e Udhëzimit Nr. 27/2023, i cili përcakton normën zero për qind të TVSH-së për projektet e financuara nga ndihma e huaj në Shqipëri, ka krijuar sfida të mëdha operacionale dhe administrative për OJF-të. Pavarësisht synimit fillestar, kërkesat e reja, si regjistrimi për TVSH i OJF-ve, procedurat për çdo blerje dhe ndërlikimet logjistike, kanë rritur barrën administrative. Kjo ka rezultuar për OJF-të ta kenë të vështirë të përfitojnë nga norma zero për qind e TVSH-së, duke rezultuar në rritjen e kostove dhe penguar veprimtarinë e sektorit.</p>
3	<p>Gjatë vitit 2023, institucionet publike nuk raportuan asnjë progres lidhur me zbatimin e Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Mungesa e një institucioni qendror koordinues ka kontribuar në mungesën e një monitorimi sistematik, raportimit dhe dialogut të kufizuar me OJF-të.</p>
4	<p>Platforma e Partneritetit për Integrim Evropian ende nuk ka arritur të përmbushë rolin e saj të synuar mbi informimin, konsultimin dhe angazhimin të shoqërisë civile në procesin e negociatave për anëtarësim në BE. Platforma mbetet e paplotë, me vetëm 26 nga 33 tryezat e diskutimit dhe konsultimit të krijuara. Pa ngritjen e plotë të 33 tryezave, platforma nuk mund të funksionojë sic synohet, pasi nuk mund të krijohet Bordi Drejtues.</p>

Rekomandimet kryesore

1	<p>Rekomandohet përshpejtimi i krijimit të Regjistrit Elektronik për të shërbyer si një mjet gjithëpërfshirës për sqarimin e të dhënave të rëndësishme mbi sektorin. Ky regjistër duhet të ofrojë informacion të përditësuar mbi madhësinë e sektorit, tipologjinë, fushat e aktivitetit, shtrirjen gjeografike, numrin e punonjësve dhe xhiron vjetore. Krijimi i këtij regjistri elektronik do të rrisë transparencën, përmirësojë saktësinë e të dhënave dhe do të mbështesë vendimmarrjen më të informuar në politikat që ndikojnë sektorin.</p>
2	<p>Për të adresuar sfidat e krijuara nga procedurat e reja të përjashtimit nga TVSH-ja, është i nevojshëm qartësimi i këtyre procedurave, me qëllim lehtësimin e barrës financiare mbi OJF-të, duke zbatuar një normë zero për qind të TVSH-së në vitin 2024 dhe duke trajtuar kompleksitetin aktual të këtyre procedurave.</p>
3	<p>Hartimi i Udhërrëfyesit të ri për Politikën dhe Masave drejt një Mjedisi më Mundësues për Shoqërinë Civile 2024-2027 duhet të përfshijë konsultime të gjera me OJF-të që në nisje të procesit. Ai duhet të bazohet në prioritetet, masa dhe indikatorë të matshëm dhe të qartë, që përputhen me zhvillimet e sektorit të OJF-ve, dokumentet strategjike kombëtare dhe Udhëzimet për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit 2021-2027.</p>
4	<p>Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian duhet të forcojë rolin e saj si një mekanizëm koordinues, duke mundësuar pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile në tryezat e diskutimit dhe konsultimit për të gjitha kapitujt e acquis të BE-së. Transparenca në këtë proces është thelbësore, duke përfshirë mënyrën se si zhvillohen tryezat dhe diskutimet, reagimet nga grupet e interesit dhe mënyrën se si ato pasqyrohen në ligjet, rregulloret dhe dokumentet përfundimtare të hartuara në tryezat e rrumbullakëta dhe grupet ndërsektoriale të punës.</p>

Fusha 1: **Garancitë Themelore Juridike të Lirive**

1.1. Liria e organizimit

1.1.1. Themelimi dhe pjesëmarrja në OJF

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kuadri ligjor garantojnë lirinë e organizimit si për individët ashtu dhe për personat juridikë, pa asnjë diskriminim. Kjo e drejtë rregullohet më tej nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë¹, Ligji Nr. 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i përditësuar², Ligji Nr. 8789/2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”³, dhe Ligji Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i përditësuar⁴. Bashkëekzistenca e dy ligjeve për regjistrimin e OJF-ve është si pasojë e mosfunksionimit të regjistrit elektronik të mandatuar nga Ligji Nr. 80/2021 (Neni 53, Ligji Nr. 80/2021).

Në lidhje me çështjet problematike të Ligjit Nr. 80/2021, të pasqyruara në Raportin MM 2021⁵, në janar 2023 një grup OJF-sh paraqitën një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese⁶. Ata kërkuan shfuqizimin e disa prej dispozitave të Ligjit Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, duke argumentuar se këto dispozita shkelin të drejtën kushtetuese për organizim. Pas seancave dëgjimore publike të zhvilluara nga Gjykata Kushtetuese me OJF-të, në nëntor 2023 gjykata pranoi pjesërisht kërkesën e tyre, duke shpallur të pavlefshme dispozitat të Ligjit Nr. 80/2021, të lidhura me regjistrimin fillestar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjykata) brenda afatit 30-ditor, atributet specifike të kancelarit dhe eliminimin e elementeve që impononin sanksione administrative ndaj OJF-ve, të cilat në kuadrin ligjor të mëparshëm parashikoheshin gjopa për deklarime të dhënash të rreme ose për mosplotësimin e detyrimeve të regjistrimit brenda afateve ligjore⁷.

Gjithashtu, Ligji për regjistrimin e OJF-ve parashikon krijimin e një **regjistri elektronik**, i cili ishte planifikuar të bëhej funksional më 30 dhjetor 2023, sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

¹ Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e përditësuar. I disponueshëm në:

<https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

² Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i përditësuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2001/05/07/8788>

³ Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2001/05/07/8789>

⁴ Fletore zyrtare 80/2021, Ligji Nr. 80/2021 Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i përditësuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2021/06/24/80/852c9af6-f25b-492e-aa48-577ff8077583>

⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, (2022), “Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2021” fq. 9-10. I disponueshëm në:

<https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-NPOs-development-country-report-for-albania-2021/>

⁶ Informacioni është marrë nga faqja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. I disponueshëm në: <https://ahc.org.al/gjykata-kushtetuese-shfuqizon-pjeserisht-disa-prej-dispozitave-te-ligjit-nr-80-2021-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/>

⁷ Fletore Zyrtare 5/2024, Vendimi nr. 60, datë 20.11.2023 i Gjykatës Kushtetuese. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6>

(KLGJ)⁸, por ende nuk është realizuar. Në korrik 2023, KLGJ-ja miratoi një vendim⁹ mbi formularët e regjistrimit dhe dokumentet që OJF-të duhet të paraqesin në Gjykatë për regjistrim. Disa çështje problematike u identifikuan rreth këtyre formularëve, të cilat pasqyrojnë paqartësi dhe konfuzion të vazhdueshëm mbi OJF-të, si për shembull: forma e subjekteve për regjistrim që bie ndesh me formën ligjore e OJF-ve përcaktuar nga Ligji “Për Organizatat Jofitimprurëse”; gjuha e formateve që duket më e përshtatur me terminologjinë e sektorit të biznesit, etj. Partnerët Shqipëri i adresoi këto shqetësime përmes një letre drejtuar KLGJ-së¹⁰, duke kërkuar gjithashtu informacion mbi funksionimin e regjistrimit elektronik, por deri në datën e përgatitjes së këtij raporti, KLGJ-ja nuk ktheu përgjigje. Ndërsa vendi ka bërë përparime të rëndësishme në reformat gjyqësore për të përmirësuar llogaridhënien, mbetet e nevojshme një dialog dhe bashkëpunim më i madh midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sektorit.

Procedurat e regjistrimit sipas Ligjit mbeten të vështira, pasi OJF-te duhet të dorëzojnë dokumentacionin e regjistrimit në Gjykatën e Tiranës, gjë që paraqet një barrë për OJF-të që ndodhen jashtë kryeqytetit. Regjistrimi i OJF-ve nuk është i detyrueshëm dhe vendimi mbetet ekskluzivisht në dorë të anëtarëve të organizatës. Megjithatë, mosregjistrimi kufizon mundësitë e grupeve informale për të mbledhur fonde, për të pasur qasje në partneritete formale dhe për të marrë pjesë në politikëbërje.

Në rastet kur anëtarët vendosin të regjistrohen, Ligji Nr. 80/2021 parashikon që regjistrimi mund të bëhet në formë të shkruar ose elektronike, sapo regjistri elektronik të bëhet funksional. Gjyqtari i caktuar merr një vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës për regjistrim. Nëse gjyqtari nuk pranon kërkesën për regjistrim, vendimi mund të apelohej në gjykatë brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit të vendimit. Bazuar në përgjigjen e marrë nga Gjykata, në praktikë koha mesatare për regjistrimin e një OJF-je nga dita e dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit është 105 ditë. Krahasuar me vitet e mëparshme, vihet re një prirje në rritje e kohës së regjistrimit të OJF-ve, nga 62 ditë në vitin 2021, në 83 ditë në vitin 2022, dhe 105 ditë në vitin 2023. Nga 121 OJF të përfshira në vëzhgimin e Raportit të Matricës së Monitorimit (MM), 6 prej tyre u regjistruan në vitin 2023. Këto organizata raportuan se procedura e regjistrimit ishte e paanshme dhe dokumentet e kërkuara ishin në linjë me ato të përcaktuara nga Ligji.

Në total, **12,768 OJF janë të regjistruara në Gjykatë**. Gjatë vitit 2023, janë regjistruar **253 OJF të reja**, të cilat përfshijnë 154 shoqata, 61 qendra dhe 38 fondacione. Gjykata refuzoi 44 kërkesa për regjistrim, duke shënuar një ulje nga 69 refuzime në vitin e kaluar, ndërsa 39 kërkesa u kthyhen për rishikim. Gjykata nuk ofroi informacion mbi arsyet e refuzimeve apo të kthimit për rishikim.

Pas regjistrimit në Gjykatë, OJF-të duhet të regjistrohen në organet tatimore. Sipas Ligjit Nr. 80/2021 (Neni 50), OJF-të që nuk regjistrohen në administratën tatimore dhe nuk aplikojnë për regjistrim brenda 12 muajve çregjistrohen automatikisht nga regjistri i organizatave jofitimprurëse. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), aktualisht janë **5,599 OJF në total të regjistruara**, prej të cilave 206 janë regjistruar gjatë vitit 2023. Vetëm 2,257 (përafërsisht 40%) prej tyre kanë status aktiv, që nënkupton se këto OJF kanë zhvilluar

⁸ Fletore zyrtare 17/2022, Vendimi Nr. 35, datë 26.01.2022 “Mbi krijimin dhe Zbatimin e Regjistrimit Elektronik për Organizatat Jofitimprurëse”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/01/26/35/af554540-b05d-4ac0-bdbe-659c59b57f8c>

⁹ Fletore Zyrtare 113/2023, Vendimi Nr. 445, datë 24.07.2023 "Për Aprovimin e Formularëve Standard të Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse". I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/07/24/445/ccaaf377-4cb1-40b4-a874-162c12a07340>

¹⁰ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2024, “Letra e Partnerëve Shqipëri drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi Vendimin Nr. 445 “Për Miratimin e Formularëve Standard të Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse”. I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/News/7085/>


veprimtari për një periudhë tatimore prej 12 muajsh radhazi. Krahasuar me Raportin MM 2022, numri i OJF-ve me status aktiv shënoi një rënie prej 240 organizatash.

Kuadri ligjor përse i përket rrjeteve u mundëson OJF-ve të krijojnë apo marrin pjesë në rrjete brenda dhe jashtë vendit pa njoftim paraprak. Nëse regjistrohen, ato duhet të marrin format ligjore të përcaktuar me ligj: qendër, shoqatë ose fondacion. Në praktikë, 86% e OJF-ve të anketuara raportuan se janë anëtare të rrjeteve kombëtare dhe 77% anëtarë të rrjeteve rajonale dhe ndërkombetare.

1.1.2. Ndërhyrja e shtetit

Kuadri ligjor garanton mbrojtjen kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OJF-ve. Ligji Nr. 8788/2001 garanton mbrojtjen kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OJF-ve, duke përcaktuar se OJF-të “*ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore*” (Neni 6) dhe se “*organet shtetërore nuk ndërhyjnë në aktivitetin e një organizate jofitimprurëse*” (Neni 7). Kjo konfirmohet edhe nga OJF-të e anketuara, shumica e të cilave nuk raportuan ndërhyrje të pajustificuara nga shteti në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme.

Grafiku 1: Ndërhyrja e shtetit në qeverisjen e brendshme të OJF-ve NPOs (nr. = 121 OJF)



Përse i përket rregulloreve për raportimin e OJF-ve ndaj autoriteteve shtetërore, OJF-te duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore brenda tre muajve pas përfundimit të vitit fiskal të mëparshëm¹¹. Konceptet dhe parimet kryesore për përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve përcaktohen në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse¹². OJF-të që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave nën 5 milionë Lekë (përafërsisht 50,000 Euro) zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënime shpjeguese lidhur me llojin e aktivitetit apo shërbimeve që ofrojnë. OJF-të që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave më të madhe

¹¹ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse. I disponueshëm në: <https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20per%20OJF/SKK%20per%20OJF.pdf>

¹² Fletore Zyrtare 171/2015, Urdhër Nr. 62, datë 17.09.2015, “Për Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, dhe zbatimin e detyrueshëm të tij”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2015/09/17/62/23a3bc4c-b8ef-4c4c-82db-abb156fe36bd>

se 5 milione Lekë (përafërsisht 50,000 Euro) duhet të dorëzojnë pasqyra financiare të plota, përfshirë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e aktivitetit dhe pasqyrën e fluksit të parave.

Sa i përket **sanksioneve**, Ligji për Procedurat Tatimore parashikon sanksione specifike nëse një OJF nuk deklaron të dhënat e saj saktë dhe nuk dorëzon pasqyrat financiare vjetore brenda afateve ligjore. Sipas Neni 112 të Ligjit për Procedurat Tatimore, mosrespektimi i detyrimeve për regjistrim ose përditësim të të dhënave dënohet për cdo shkelje me gjobë prej 10,000 Lekësh (përafërsisht 100 Euro) për personat fizikë dhe 15,000 Lekësh (përafërsisht 150 Euro) për personat juridikë. Sanksione specifike janë përcaktuar gjithashtu në Ligjin për Regjistrin e Pronarit Përfitues për rastet e mosregjistrimit ose përditësimit të të dhënave, siç është theksuar në Raportin MM 2022¹³. Sipas përgjigjes së marrë nga DPT-ja, gjatë vitit 2023, asnjë organizatë nuk mori sanksione.

Në praktikë, 95% e OJF-ve të anketuara raportuan se nuk kanë marrë sanksione gjatë vitit 2023. Ndër gjashtë OJF që raportuan se kishin marrë sanksione, dy prej tyre deklaruan se sanksionet ishin proporcionale me shkeljen, ndërsa katër të tjerat i konsideruan të tepruara. Sanksionet e përmendura nga këto katër organizata lidhen me deklarin e pronarëve përfitues në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Intervistat e thelluara me këto organizata zbuluan se tre prej tyre kishin marrë sanksione për mosrespektim të kërkesave të aplikimit sipas detyrimeve ligjore. Ato raportuan se nuk ishin informuar nga QKB-ja, pavarësisht se ligji kërkon që QKB-ja të sigurojë një afat 30-ditor për të adresuar çështjet¹⁴. Një organizatë theksoi se QKB-ja kishte vendosur sanksione për shkak të natyrës retrospektive të vendimeve të gjykatës mbi ndryshimet statutoare të organizatës dhe mungesës së komunikimit nga Gjykata.

Lidhur me pronarët përfitues të OJF-ve, sipas Raportit Vjetor 2023 të QKB-së, **4,622 OJF kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues**, që përbën 94.75% të të gjitha OJF-ve. Gjatë vitit 2023, QKB-ja ka marrë 270 kërkesa nga OJF-të për regjistrimin e pronarëve përfitues, prej të cilave 210 janë miratuar dhe 60 janë refuzuar¹⁵. Si në vitet e kaluara, Partnerët Shqipëri dërgoi një kërkesë për informacion QKB-së. Pavarësisht, përpjekjeve të vazhdueshme për të marrë informacion për OJF-të në lidhje me pronarët përfitues, QKB nuk ktheu përgjigje.

Në lidhje me **Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin të Terrorizmit (PPP/FT)** për OJF-të, Ligji Nr. 9917/2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar¹⁶, nuk i konsideron OJF-të si subjekte raportuese, por si klientë të subjekteve raportuese. Megjithatë, OJF-të janë një nga kategoritë e klientëve që i nënshtrohen vigjilencës së zgjeruar (Neni 8, Ligji Nr. 9917/2008). Gjithashtu, Rregullorja e Bankës së Shqipërisë¹⁷ dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare¹⁸ përmbajnë dispozita për kujdesin e

¹³ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, (2023) “Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2022”, fq. 9-10. I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2023/07/monitoring-matrix-report-2022.pdf>

¹⁴ Neni 6, pika 4 e Ligjit Nr. 112/2020 “Për regjistrin e Pronarit Përfitues”, i ndryshuar. I disponueshëm në: file:///C:/Users/kostandina.keruti/Downloads/2020%20_P%20REGJISTRIN%20E%20PRONAR%20C%20P%20PERFITUES.pdf

¹⁵ Qendra Kombëtare e Biznesit (2024) “Raporti Vjetor 2023”. I disponueshëm në: <https://qkb.gov.al/media/38391/Raport%20Vjetor%20per%20Regjistrin%20Tregtar,%20Regjistrin%20e%20Leje,%20Licencave%20dhe%20Autorizimeve%20dhe%20Regjistrin%20e%20Pronarit%20Perfitues%202023.pdf>

¹⁶ Fletore Zyrtare 83/2008 “Për Parandalimin e Financimit të Pastrimit të Parave dhe Financimin të Terrorizmit”. i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qkb.gov.al/eli/ligji/2008/05/19/9917/bb9b5ab1-5309-45e0-87c7-aab63d0937ae>

¹⁷ Banka e Shqipërisë, (2009), “Rregullorja Nr. 44/2019 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin të Terrorizmit”, version i integruar. I disponueshëm në: https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Nr_44_date_10_06_2009_Rregullorja_per_Parandalimin_e_Pastrimit_te_Parav_1627_8.pdf

¹⁸ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, 2015, “Rregullorja Nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar. I

shtuar paraprak për shërbimet dhe produktet financiare që u ofrohen OJF-ve. Bankat janë të detyruara të zbatojnë vigjilencë të zgjeruar, që ndër faktorë të tjerë, përfshin verifikimin e qëllimit të transfertave, natyrës së marrëdhënies të bërit biznes dhe përfituesit përfundimtar. OJF-të duhet të depozitojnë çdo ndryshim si në Gjykatë, ashtu edhe në bankat e nivelit të dytë me të cilat kryejnë transaksione.

Në vitin 2023, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) publikoi raportin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut (VKR)¹⁹. Gjatë nëntorit AIF organizoi një takim konsultues me një grup të vogël OJF-sh, mbi seksionin e organizatave jofitprurëse të raportit, për të verifikuar të dhënat e rezultuara nga vlerësimi kombëtar mbi masat e fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik për adresimin e financimit të terrorizmit (FT) në sektorin e OJF-. Në versionin publik të VKR-së, Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut për OJF-të, e zhvilluar përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Partnerëve Shqipëri dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përfshirjen e AIF-së, agjencive ligjzbatuese dhe OJF-ve, përmendet si një nga masat kyçe për zbutjen e rrezikut të FT-së në sektorin e OJF-ve. Më e rëndësishmja, përfundimet e vlerësimit kombëtar janë në përputhje me gjetjet e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut për OJF-të, duke konfirmuar një rrezik të ulët të FT-së në sektorin e OJF-ve. Ky zhvillim përfaqëson një hap pozitiv drejt adoptimit të një qasjeje të bazuar në rrezik, që mund të çojë në deklasifikimin e sektorit të OJF-ve si një klient "me rrezik të lartë" nga subjektet që zbatojnë masa të zgjeruara për OJF-të.

Sipas përgjigjes së marrë nga AIF-ja, në vitin 2023 u raportuan 2 raste të dyshuara për pastrim parash (PP) dhe 2 raste të dyshuara për financim të terrorizmit (FT) të lidhura me OJF-të, nga subjektet raportuese. Tipologjitë për dy rastet e PP-së përfshinin (i) transferata në vlera të larta në mbërritje nga jashtë në llogari të një shoqate të regjistruar në vendin tonë pa dokumentacion justifikues për burimin e fondeve dhe me përfitues final më tej një OJF tjetër po e regjistruar në vendin tonë pa një dokumentacion në lidhje me përdorimin e fondeve, dhe (ii) depozitime të copëzuara në cash në llogari personale nga shtetas të lidhur me OJF-në, me dyshime që fondet kanë prejardhjen nga vetë OJF-ja. Fondet e përfituara në këtë mënyrë janë investuar në pasuri të paluajtshme.

Tipologjitë për dy rastet e financimit të terrorizmit (FT) përfshinin: (i) të dhëna negative për përfaqësuesin ligjorë të një OJF-je për aktivitete të dyshimta të lidhura me FT në një vend fqinj dhe (ii) transferimin e fondeve nga OJF-të të regjistruar në vendin tonë drejt një organizate të huaj jashtë vendit, e dyshuar për përfshirje në aktivitete të FT.

Në praktikë, 8% e OJF-ve të anketuara raportojnë qasje të kufizuar në shërbimet bankare dhe financiare. Disa nga kufizimet e pretenduara nga OJF-të përfshijnë:

- Ngrirje të llogarisë bankare të organizatës për shkak të mosshlyerjes së taksave mbi pronën. Organizata pretendon se prona ishte dëmtuar nga tërmeti dhe ishte klasifikuar nga shteti si e pabanueshme. Ajo deklaroi se kishin paguar taksat mbi pronën për tre vite radhazi, pasi ishin në proces për të marrë fonde.
- Kërkesa nga bankat për prezencë fizike për dorëzim dokumentacioni shtesë (kontrata, anekse, certifikata dhe dokumentacion stafi), duke penguar aksesin në e-banking.
- Vonesa në vendimin e Gjykatës lidhur me ndryshimin e dokumentacionit të OJF-së, rezultoi në bllokimin e llogarive nga bankat.

disponueshëm në: <https://amf.gov.al/readLaw.asp?id=211>

¹⁹ Agjencia e Inteligjencës Financiare, 2024, "Vlerësimi Kombëtar i Riskut". I disponueshëm në: https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Vleresimi_Kombetar_Riskut.pdf

- Përditësime gjashtëmujore të dokumentacionit të organizatës, ku çdo 6 muaj banka kërkon vendime gjyqate për organizatën dhe informacion mbi donatorët.
- Procedura burokratike dhe kontroll të shtuar mbi donatorët, duke kërkuar kontrata dhe informacion të detajuar për ta.

Duke gjykuar nga problematikat e mësipërme, disa faktorë kanë kontribuar në këtë situatë, përfshirë mungesën e ndërgjegjësimit nga ana e OJF-ve për detyrimet e tyre ligjore kur hyjnë në kontrata shërbimi me bankat, siç është dorëzimi i dokumenteve të regjistrimit dhe raportimi i ndryshimeve statutores brenda organizatës. Gjithashtu, disa banka vendosin masa të tepërta, duke krijuar pengesa përmes kërkesave për informacion që tejkalojnë kufijtë e kërkesave ligjore.

Lidhur me **çregjistrimin**, nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 8788/2001 parashikojnë që OJF-të mund të shpërbëhen vullnetarisht përmes vendimit të organit më të lartë vendimmarrës. Gjithashtu, Gjykata mund të urdhërojë shpërbërjen e një OJF-je nëse aktivitetet e saj shkelin Kushtetutën e Shqipërisë, përfshijnë veprime të paligjshme, nuk janë themeluar sipas kërkesave ligjore ose nëse OJF-ja bëhet e paaftë për të përmbushur detyrimet e saj financiare. Pas shpërbërjes, çdo pasuri e mbetur duhet të transferohet tek organizata të tjera, siç përcaktohet nga organi më i lartë vendimmarrës. Në rastet kur shpërbërja urdhërohet nga Gjykata, pasuritë do t'u kalohen organizatave me objektiva të ngjashme me ato të organizatës të shpërbërë, siç përcaktohet nga Gjykata. Sipas Ligjit Nr. 80/2021, një OJF mund të çregjistrohet përmes veprimit vullnetar, vendimit të gjykatës ose dispozitave specifike ligjore. Sipas informacion të marrë nga Gjykata, 15 kërkesa u pranuan në vitin 2023 për likuidim dhe çregjistrim të OJF-ve.

1.1.3. Sigurimi i burimeve financiare

Kuadri ligjor u lejon OJF-ve të kërkojnë dhe sigurojnë mbështetje financiare për aktivitetet e tyre nga burime vendase dhe të huaja, përfshirë grante, dhurime dhe burime të tjera. Gjithashtu, si fondacionet ashtu edhe shoqatat lejohen të angazhohen në investime pasive²⁰, duke u mundësuar atyre "të zotërojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, për të gjeneruar të ardhura përmes menaxhimit të këtyre pasurive"²¹. OJF-të gjithashtu mund të kryejnë aktivitet ekonomik.

Në praktikë, financimi i huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave për OJF-të. Grafiku 2 paraqet burimet e të ardhurave të OJF-ve gjatë vitit 2023. Siç vërehet, 67% e OJF-ve të anketuara raportuan se kanë siguruar fonde nga donatorë dypalësh, institucione private të huaja dhe agjenci ndërkombëtare për zhvillim dhe bashkëpunim. Bashkimi Evropian renditet në vend të dytë, duke siguruar burim të ardhurash për 46% të OJF-ve të anketuara. Gjithashtu, gjatë vitit 2023, OJF-të siguruan dhurime nga burime private (individë, OJF të tjera ose subjekte private), të cilat mbështetën aktivitetet e tyre dhe siguruan të ardhura për 60% të OJF-ve të anketuara. Krahasuar me raportet e mëparshme të MM-së²², vihet re një trend në rritje të dhurimit, me rreth 50% më shumë dhurime nga burime private për mbështetjen e aktiviteteve të OJF-ve. Fondet


²⁰ Investimet pasive përfshijnë interesa, dividendë, fitime kapitale dhe të ardhura të tjera të gjeneruara nga investimi i pasurisë së organizatës.

²¹ Neni 39/1 dhe Neni 56/1 i Kodit të Republikës së Shqipërisë.

²² Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, (2021), "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2020", fq. 23, I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>

publike mbeten të pamjaftueshme për funksionimin e OJF-ve. Vetëm 11% e 121 OJF-ve të anketuara deklaruan se kishin marrë fonde nga institucionet e qeverisë qendrore dhe 14% nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore gjatë vitit 2023. Asnjë nga OJF-të nuk raportoi kufizime nga autoritetet publike për marrjen e fondeve të huaja.

Grafiku 2: Burimet e të ardhurave të OJF-ve të anketuara (pyetje me shumë alternativa zgjidhesh nr. =121 OJF)



OJF-të mund të kryejnë aktivitet ekonomik. Megjithatë, mungesa e stimujve fiskalë për OJF-të që punësojnë grupe të margjinalizuara, së bashku me paqartësitë dhe kufizimet që vendos kuadri ligjor aktual, mbeten sfida të vazhdueshme, të raportuara edhe në raportet e mëparshme të MM-së. Sipas vëzhgimit të kryer me OJF-të, 32 nga 121 organizata deklaruan se kryejnë aktivitet ekonomik. Nga ky grup OJF-sh, vetëm 3 regjistruan aktivitetin e tyre ekonomik duke marrë një Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) të dytë²³, si organizatë jofitimprurëse.

Studimi i kryer nga Partnerët Shqipëri, gjatë vitit 2022, me pjesëmarrjen e 153 OJF-ve tregoi se 68% e tyre hasin vështirësi administrative për shkak të kërkesave të shtuara të kujdesit nga bankat e nivelit të dytë. Sa i përket kredive, përmbushja e kritereve varet nga aftësia e OJF-ve për të ofruar kolateral dhe për të dëshmuar një kapacitet të qëndrueshëm për shlyerjen e tyre. Për të përfutur kredi, OJF-të duhet të provojnë se kanë projekte të qëndrueshme që mbulojnë periudhën e shlyerjes.

²³ NUIS dytësor është i njëjti numër i organizatës por me vendodhje të ndryshme

1.2. Liritë e tjera

1.2.1. Liria e tubimeve paqësore

E drejta për tubime paqësore është një e drejtë kushtetuese (Neni 46) dhe rregullohet nga Ligji Nr. 8773/2001 “Për Tubimet”²⁴. Ky ligj është në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe konventat e ratifikuara nga vendi. Ai i garanton çdo qytetari të drejtën për të organizuar dhe për të marrë pjesë lirish në tubime legjitime, duke i lejuar ata të shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre mbi çështjet me interes. Ligji “Për Tubimet” njeh organizimin e këtyre llojeve të grumbullimeve: (i) tubime të organizuara në sheshe dhe rrugë publike; (ii) tubime të mbajtura në vende të hapura për publikun, të përcaktuara si vende të aksesueshme nga të tjerët, ku mund të vendosen kushte për hyrjen (p.sh., stadione, kinema, teatro, etj.); dhe (iii) tubime të organizuara në zona private.

Ligji gjithashtu njeh edhe "tubimet urgjente," të cilat janë grumbullime të organizuara në përgjigje të rrethanave të caktuara. Një zhvillim pozitiv drejt garantimit të lirisë së tubimit paqësor ishte ndryshimi i nenit 262 të Kodit Penal: "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme". Ky ndryshim erdhi si rezultat i vendimit të Gjykatës Kushtetuese më 5 maj 2021²⁵, e cila vendosi për ndryshimin e Nenit 262, i cili më parë e klasifikonte si të paligjshme organizimin e tubimeve pa lejen e policisë.

Ligji është nuk është shpjegues lidhur me procesin e ankimit, duke theksuar se ankimet duhet të realizohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ai nuk jep detaje mbi mënyrën ose afatin e dorëzimit të ankimit, autoritetin përgjegjës për shqyrtimin e tij, apo kohën e nevojshme për marrjen e një vendimi që mundëson zhvillimin e tubimit.

Policia e Shtetit Shqiptar nuk iu përgjigj kërkesës për informacion së Partnerëve Shqipëri lidhur me tubimet e organizuara gjatë vitit 2023. Sipas përgjigjes së marrë nga Avokati i Popullit, gjatë vitit 2023, institucioni nuk ka identifikuar raste apo marrë ankesa nga OJF-të lidhur me lirinë e tubimit. Megjithatë, ka shembuj që pasqyrojnë mënyrën se si autoritetet kanë përdorur masa ligjore dhe administrative për të kufizuar protestat. Për ilustrim, sipas CIVICUS Monitor²⁶, aktivistët në mbrojtje të mjedisit kanë protestuar kundër ndërtimit të aeroportit të Vlorës pranë Lagunës Vjosë-Nartë, duke argumentuar kërcënimet që ai paraqet për biodiversitetin. Këto protesta kanë qenë paqësore duke përfshirë veprime simbolike si mbjellja e pemëve. Megjithatë, ka pasur tensione me autoritetet, përfshirë sfida ligjore për disa aktivistë dhe kufizime të vendosura nga policia mbi protestat e tyre.

Nga vëzhgimi me OJF-të, 21 OJF deklaruan se organizuan tubime paqësor gjatë vitit 2023. Nga përvoja e tyre, 48% dorëzuan kërkesë për autorizim pranë institucioneve përgjegjëse, ndërsa 14% raportuan kufizime lidhur me vendin dhe kohën e dëshiruar. Nga intervistat e thelluara, disa OJF që kishin dorëzuar kërkesa për organizimin e tubimeve deklaruan se kjo është një kërkesë e


²⁴ Fletore Zyrtare 23/2001, Ligji Nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/04/23/8773>

²⁵ Fletore zyrtare 87/2021, Vendimi Nr. 24, datë 04.05.2021. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/04/24/ca2d2e4d-3fc2-46da-a852-29a63dbd5dc0>

²⁶ Informacioni është marrë nga CIVICUS Monitor. I disponueshëm në: <https://monitor.civicus.org/explore/journalist-covering-forgery-case-beaten-in-shocking-attack/>

Bashkisë së Tiranës për t'i dorëzuar këto kërkesa para zhvillimit të tubimit. Sa i përket kufizimeve, 10% e OJF-ve të anketuara raportuan kufizime për kohën e dëshiruar dhe 14% për vendin e dëshiruar. Sipas këtyre OJF-ve, kufizimet në kohë, të përcaktuara nga Policia e Shtetit, lidhen me shqetësime të sigurisë për shkak të protestave të palës kundërshtare, ndërsa kufizimet në vend lidhen me ruajtjen e rendit publik. Asnjë nga OJF-të nuk apeloj vendimin.

Grafiku 3: Eksperiencia e OJF-ve në organizimin e tubimeve paqësore (nr. =21 OJF)



Nga të dhënat e vëzhgimit, 17% e OJF-ve raportuan pjesëmarrje në tubime të njëkohshme, ndërsa 7% deklaruan se kanë marrë pjesë në tubime spontane.

Gazetarët dhe mediat lejohen të marrin pjesë në tubime paqësore. Nuk u identifikuan kufizime të mëdha për aksesin e medias, as sfida të hasura nga gazetarët gjatë raportimit në tubime në vitin 2023. Sipas përgjigjes së marrë nga Avokati i Popullit, në vitin 2023, institucioni nuk identifikoi asnjë rast ose nuk mori ankesa nga OJF-të për kufizime të medias në tubime. Megjithatë, organizatat që punojnë me median theksuan kufizimet në aksesin e mediave në tubime publike, veçanërisht gjatë protestave paqësore dhe grumbullimeve publike. Për shembull, gjatë protestave për çështje mjedisore dhe sociale, gazetarët hasën raste të kufizimit të aksesit, gjë që uli transparencën e këtyre protestave. Këto sfida theksojnë nevojën urgjente për mbrojtje më të forta për të siguruar lirinë e informacionit dhe garantimin e aksesit të mediave në tubime publike në Shqipëri²⁷.

1.2.2. Liria e shprehjes

Liria e shprehjes është një të drejtë kushtetuese. Në prill 2023, Parlamenti miratoi Ligjin Nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2023 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë'" ²⁸. Ky Ligj përshtatet pjesërisht me Direktivën Evropiane për Shërbimet e Medias Audiovizive 2010/13/BE dhe prezanton masa për të luftuar gjuhën e

²⁷ Ky informacion është marrë nga faqja e intertetit të organizatës SCiDEV. I disponueshëm në: [European Commission's 2024 Report Highlights Persistent Obstacles to Media Freedom in Albania – SCiDEV](#)

²⁸ Fletore Zyrtare 17/2023, Ligji Nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". I disponueshëm në: <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Ligji-nr.-30-2023-Per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-ligjin-nr.-97-2013-Per-mediat-Audiovizive-ne-Republiken-e-Shqiperise-te-ndryshuar.pdf>

urrejtjes dhe dezinformimin. Në nivelin legjislativ, u krijua Komiteti i Posaçëm Parlamentar²⁹ për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale të drejtuara për të luftuar dezinformimin dhe forma të tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit. Objektivat e këtij Komiteti përfshijnë: (i) rishikimin e kuadrit ligjor dhe praktik për ndalimin e ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike dhe zgjedhore; (ii) forcimin e kuadrit ligjor dhe masave institucionale për mbrojtjen e sigurisë kombëtare nga investimet e dëmshme të huaja; (iii) rishikimin e kuadrit ligjor dhe praktik për ndalimin e ndërhyrjeve të huaja në ekonomi dhe sektorë të tjerë kritikë; dhe (iv) mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes, lirisë së mediave, pluralizmit online dhe offline, aksesit në informacion, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe inkurajimin e debatit publik për angazhimin kundër dezinformimit. Zhvillimet brenda këtij Komiteti do të raportohen në raportin e ardhshëm të Matricës së Monitorimit.

Një fenomen tjetër që ndeshet në vitet e fundit është rritja e Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Këto padi shërbejnë si mjete për të intimiduar individët të heshtin. Megjithëse nuk ka një përkufizim ligjor, publikimi i Partnerëve Shqipëri mbi SLAPP-et identifikoi se gazetarët, mediat investigative dhe OJF-të që punojnë në fushën mjedisore janë më shpesh të targetuar për SLAPP-e në Shqipëri³⁰.

Fyerja mbetet një vepër penale, edhe pse nuk lejohet dënimi me burg.

Pavarësisht se liria e shprehjes është garantuar nga kushtetuta, shenja të përkeqësimit u vunë re vazhdimisht përgjatë vitit 2023³¹. Në Indeks Botëror të Lirisë së Shtypit, Shqipëria u rendit e 99-ta, duke humbur tre pozita krahasuar me vitin e kaluar. Indeksi thekson konflikte interesi midis sektorit të biznesit dhe politikës, një kuadër ligjor të mangët dhe rregullore që rrezikojnë lirinë e shtypit dhe pavarësinë e mediave. Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri për vitin 2023 identifikoi mungesën e mediave të pavarura si një shqetësim kryesor në lidhje me të drejtat e njeriut në vend. Për më tepër, raporti thekson faktin se qytetarët shqiptarë që kritikuan publikisht qeverinë dhe politikanët kyç shpesh u përballën me fushata shpifjeje nga mbështetësit e qeverisë dhe liderët politikë³².

Grafiku 4 tregon përvojën e OJF-ve në ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes. Ky rezultat vjen *për shkak* se shumica e OJF-ve të anketuara punojnë në fushën e shërbimeve sociale për grupet e marginalizuara dhe në çështje mjedisore. Në përgjithësi, shumica e OJF-ve të anketuara gëzojnë lirinë e shprehjes. Nga vëzhgimi, OJF-të e medias dhe organizatat për të drejtat e njeriut raportojnë presion për fjalimet kritike ndaj qeverisë ose entiteteve private si dhe vetëcensurë.


²⁹ Informacioni është marrë nga faqja e Kuvendit të Shqipërisë. I disponueshëm në: <https://parlament.al/struktura/8e230ff7-5344-45fb-bd6c-510f927c6b92>

³⁰ Këruti, K., 2024, "Nga Heshtja në Fuqi – Një Përgjigje Rajonale e SLAPP-eve në Ballkanin Perëndimor, Raporti për Shqipërinë", I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/from-silence-to-strength-a-regional-response-to-slapps-in-the-western-balkans/>

³¹ Bino, B., 2022, "Treguesit mbi Nivelin e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022" I disponueshëm në: <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2023/03/ALB-ENG-2022.pdf>

³² Departamenti Amerikan i Shtetit (2023), "Raporti për të drejtat e njeriut 2023 – Shqipëria", I disponueshëm në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2024/01/528267_ALBANIA-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf

Grafik 4: Eksperienca e OJF-ve në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes (nr. = 121 OJF)



1.2.3. Hapësira të hapura, të sigurta qytetare

Kuadri ligjor që rregullon sigurinë e komunikimeve elektronike përcaktohet nga Ligji Nr. 9918/2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka transpozuar direktivat e BE-së për komunikimet elektronike³³. Ky ligj përmban dispozita që mbrojnë konfidencialitetin e komunikimeve. Ai ndalon përgjimin e komunikimeve pa justifikim ligjor, duke ndihmuar në mbrojtjen e OJF-ve nga mbikëqyrja e pajustificuar nga autoritetet. Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025³⁴. Kjo strategji thekson parime kyçe si mbrojtja e të drejtave themelore, respektimi i lirisë së shprehjes, mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë, sigurimi i aksesit për të gjithë, promovimi i qeverisjes demokratike dhe efektive, si dhe nxitja e përgjegjësisë kolektive për ruajtjen e sigurisë kibernetike.

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale. Neni 35 specifikisht përcakton që mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Gjithashtu, Ligji Nr. 9887/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pjesërisht përputhet me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Evropian. Ky ligj ofron një kuadër për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, përfshirë dispozita që ndalojnë monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave pa autorizim nga autoritetet. Ai kërkon pëlqimin për mbledhjen e të dhënave personale dhe përcakton të drejta për individët mbi informacionin që lidhet me ta.

Kuadri rregullator lidhur me sigurinë kibernetike synon të trajtojë aspekte të ndryshme të krimeve kibernetike, duke përfshirë ndërhyrjen e paligjshme në të dhëna, aksesin e paautorizuar

³³ Fletore Zyrtare 197/2018, Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008, "Mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/197/c296680f-0015-4e9c-8bef-76fb6f7bb626>

³⁴ Vendimi Nr. 1084, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike dhe Planit të Veprimit të saj 2020 - 2025". I disponueshëm në: <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/National-Cybersecurity-Strategy-and-its-Action-Plan-2020-2025.pdf>

në sisteme informative dhe veprat penale të lidhura me përmbajtjen. Ky kuadër ofron baza për bashkëpunimin midis agjencive të zbatimit të ligjit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, për të luftuar kërcënimet kibernetike. Për më shumë, Ligji për Komunikimet Elektronike përmban dispozita që lidhen me konfidencialitetin e komunikimeve dhe ndalon përgjimin e paautorizuar, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e të drejtave individuale në hapësirën digjitale. Sa i përket mekanizmave, Policia e Shtetit Shqiptar ka njësi të dedikuara për mbrojtjen e individëve, veçanërisht atyre që përballen me kërcënime për shkak të aktivizmit të tyre. Këto njësi vlerësojnë kërcënimet dhe mund të ofrojnë masa sigurie sipas nevojës. Avokati i Popullit mund të ndërhyjë në emër të individëve ose organizatave që përballen me ngacmime apo kërcënime. Ky institucion luan një rol kyç në monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mund të rekomandojë veprime ndaj qeverisë.

Kuadri ligjor në Shqipëri nuk kufizon përdorimin e medias online. Sipas Raportit Digjital, Shqipëria kishte 2.27 milionë përdorues interneti dhe 1.60 milionë përdorues të mediave sociale në fillim të vitit 2023. Interneti dhe platformat e mediave sociale shërbejnë si mjete efektive për OJF-të për të promovuar aktivitetet e tyre dhe rritur transparencën me publikun. Sipas raportit "Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri"³⁵ shumica e OJF-ve (66% e 113 të anketuarave) përdorin mediat sociale si platforma për të komunikuar me publikun.

Megjithatë, ka raste në praktikë, edhe të sulmeve të medias online, si p.sh. media online Citizens Channel, e cila u përball me një sulm kibernetik nga autorë të panjohur. Pas heqjes së postimeve të saj nga Facebook si 'përmbajtje spam' në atë që dukej të ishte një përpjekje e koordinuar, Citizens Channel pësoi një sulm të dyshuar DDoS (Distributed Denial-of-Service) në faqen e saj të internetit. Ky incident ngriti shqetësime mbi lirinë e medias dhe aksesin në informacion të pavarur në Shqipëri. Citizens Channel pretendoi se qeveria mund të ishte e përfshirë në hakërimin e kanaleve të saj të komunikimit online, edhe pse nuk pati prova që mbështetën këto pretendime. Gjithashtu, publikimi i Rrjetit të Kërkimeve për Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor³⁶ theksoi nevojën për një integrim më të qartë të masave të sigurisë kibernetike. Ai rekomandon ndryshime rregullatore dhe përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave për aktorët publikë, duke inkurajuar njëkohësisht shoqërinë civile që të monitorojë shkeljet dhe të rrisë ndërgjegjësimin.

Bazuar në përgjigjen e marrë nga Avokati i Popullit, gjatë vitit 2023 nuk janë raportuar raste të shkeljeve të komunikimit online apo ankesa të lidhura me sigurinë kibernetike. Nga vëzhgimi i OJF-ve tregon se shumica prej tyre gëzojnë të drejtën për një hapësirë qytetare të hapur, të sigurt dhe të mbrojtur, si offline ashtu edhe online. Sipas Raportit të Freedom House 2023³⁷, gazetarët dhe përfaqësuesit e OJF-ve, veçanërisht ata që raportojnë mbi korrupsionin apo çështjet e të drejtave të njeriut, kanë përjetuar raste ndërhyrjesh. Edhe pse autoritetet kanë nisur hetime, shpeshherë është vënë në pikëpyetje shpejtësia dhe cilësia e këtyre hetimeve. Raportet sugjerojnë se shumë viktime nuk arrijnë të shohin drejtësi, duke shkaktuar mungesë besimi tek institucionet e rendit.

³⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2024, "Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri - Raport Vlerësimi", I disponueshëm në: <https://resourcecentre.al/2024-publication/capacity-and-needs-assessment-of-civil-society-organisations-in-albania/>

³⁶ Rrjeti i Kërkimeve për Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor, 2022, "Siguria Kibernetike dhe të Drejtat e Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Hartëzimi i Qeverisjes dhe Aktorët". I disponueshëm në: <https://www.dcaf.ch/cybersecurity-and-human-rights-western-balkans-mapping-governance-and-actors>

³⁷ Raporti i Freedom House 2023, I disponueshëm në: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2023>

Fusha 2: **Kuadri për Qendrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OJF-të**

2.1. **Trajtimi tatimor/ fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre**

2.1.1. **Përfitimet tatimore**

Bazuar në legjislationin në fuqi, të ardhurat nga burimet tradicionale jofitimprurëse të OJF-ve, si grantet, kuotat e anëtarësimit, dhurimet private ose korporative, nuk i nënshtrohen Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Në lidhje me TVSH-në, në shtator 2023, Ministria e Financave miratoi Udhëzimin Nr. 27, datë 13.09.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 6, datë 30.01.2015, ‘Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, i cili ndryshon Udhëzimin 6/2015 mbi TVSH-në në Shqipëri³⁸. Ky udhëzim i ri prezanton një normë TVSH-je prej 0 për qind për mallrat dhe shërbimet që përdoren në projektet e financuara nga financimet e huaja, duke zëvendësuar procedurën e mëparshme që lejonte rimbursimin e TVSH-së në përfundim të projektit. Për të siguruar trajtimin me normën e tatimit mbi vlerën e shtuar prej zero për qind, zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorët, duhet të regjistrohen për qëllime të TVSH-së pranë autoriteteve tatimore, dhe zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të regjistrohet pranë Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës (SASPAC).

Së pari, kërkesa që OJF-të të regjistrohen pranë autoriteteve tatimore për qëllime të TVSH-së përbën një hap prapa. Kjo kërkesë cenon përpjekjet për të krijuar një mjedis mbështetës për veprimtaritë e OJF-ve, duke zhbërë progresin e arritur gjatë viteve kur OJF-të ishin të përjashtuara nga skema e TVSH-së.

Së dyti, jo vetëm që OJF-të duhet të dorëzojnë një kopje të noterizuar të kontratës me donatorin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), por edhe furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve duhet të dorëzojë një kontratë të nënshkruar me OJF-në për çdo blerje, pavarësisht nga shuma. Kjo do të thotë që për çdo blerje duhet të nënshkruhet një kontratë midis OJF-ve dhe furnizuesit të shërbimeve ose mallrave, dhe një certifikatë trajtimi për TVSH-në, e ngjashme me atë për eksportin, duhet të lëshohet nga DRT-ja për qëllime të TVSH-së.

Së treti, duke pasur parasysh se një OJF mund të veprojë në qytete të ndryshme, sfidat logjistike të regjistrimit të furnizuesve të mallrave dhe shërbimeve në vende të ndryshme, të kombinuara me kostot e larta administrative për transaksione me vlera të ulëta, e bëjnë sektorin e OJF-ve më pak tërheqës për biznesin, duke rezultuar potencialisht në refuzim të shërbimeve. Ky kompleksitet kontribuon në demotivimin e furnizuesve privatë për të punuar me OJF-të, veçanërisht kur kostot administrative tejkalojnë vlerën e transaksioneve me kosto të ulët.

Për më tepër, sistemi i e-filing e shton kompleksitetin, duke shkaktuar vonesa dhe pasiguri. Mungesa e udhëzimeve mbi ndikimin e procedurës tek OJF-të më të vogla, përfituesë së

³⁸Fletore Zyrtare O137/2023, Udhëzimi Nr. 27, datë 13.09.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/137/c168f9e3-96bb-4897-9050-5e798bb527d9>

skemave të nën-grantimit e përkeqëson më tej këtë situatë. Për shkak të mosfunksionimit të procedurës së TVSH-së me normë zero për qind, barra për sektorin është bërë edhe më e rëndë. Aktualisht, sektori e ka TVSH-në si një kosto 100% për gjithë buxhetin e tij, pa asnjë mundësi për rimbursim ose aplikim të normës zero për qind.

Në lidhje me trajtimin fiskal, Ligji i ndryshuar "Për TVSH-në" specifikon në Nenin 3 se burimet e të ardhurave jofitimprurëse të OJF-ve, si kuotat e anëtarësimin, grantet dhe dhurimet, nuk i nënshtrohen TVSH-së. Megjithatë, nëse një OJF angazhohet në veprimtari ekonomike për të gjeneruar të ardhura për financimin e aktiviteteve të saj të lidhura me misionin, ajo konsiderohet si subjekt tatimor dhe duhet të regjistrohet për TVSH-në, pavarësisht nga qëllimi i aktivitetit. Një përjashtim aplikohet për OJF-të që merren me aktivitete sociale, arsimore, kulturore ose sportive, të cilat konsiderohen "aktivitete me interes të përgjithshëm" dhe përjashtohen nga Ligji për TVSH-në (Neni 51, pika e, f, i, j, k), të detajuara më tej nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014, "Për Zbatimin e Dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar³⁹. Mallrat dhe shërbimet duhet të ofrohen bazuar në çmime të miratuara nga autoritetet kompetente. Në rastet kur çmimet nuk janë të miratuara, ato duhet të jenë më të ulëta se çmimet e tregut për të njëjtat shërbime.


OJF-të duhet të plotësojnë tre kritere njëkohësisht për të përfituar nga përjashtimi: (i) organet drejtuese të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës; (ii) veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë; dhe (iii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës. Procedura për përjashtimin nga TVSH-ja (Neni 3) kërkon dorëzimin në DRT të një grupi dokumentesh, si: vendimi i regjistrimit në gjykatë, statuti dhe akti i themelimit; deklarata për të gjitha shërbimet dhe mallrat e ofruara dhe lista e çmimeve; deklarata e misionit dhe fushat kryesore programatike; lista e grupeve përfituese; dhe burimet financiare, duke përfshirë të ardhurat e pritshme nga aktiviteti ekonomik. Përjashtimi nga TVSH-ja është i vlefshëm për tre vjet me të drejtë rinovimi. Kur aplikohet për herë të parë, statusi është i vlefshëm për një vit.

Bazuar në përgjigjen e DPT-së, 20 OJF kanë regjistruar projektet e tyre, si pjesë e programit IPA II (nga 35 projekte gjithsej) për qëllime të TVSH-së, ku 4 OJF i kanë regjistruar projektet e tyre në vitin 2023. Rimbursimi është përfunduar për 3 prej këtyre projekteve brenda vitit 2023, sipas udhëzimit Nr. 34, datë 2.12.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 6, datë 30.01.2015, 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar.

Në praktikë, OJF-të e vëzhguara nuk raportuan taksa të fshehura mbi grantet. Megjithatë, qëndrueshmëria financiare mbetet ndër aspektet më të dobëta për OJF-të. Rreth 12% e OJF-ve raportuan se nuk kishin asnjë burim të ardhurash gjatë vitit 2023, siç tregohet në Grafikon 5. Organizatat që përballen me vështirësitë më të mëdha për të siguruar fonde janë kryesisht organizatat të reja të themeluara në vitet 2022 dhe 2023, të vendosura në qytete të vogla si Kuçova, Puka, Pogradeci, Mirdita, Bulqiza dhe Vau i Dejës. Në të kundërt, organizatat që raportojnë të ardhura më të larta vjetore janë kryesisht ato që ofrojnë shërbime sociale dhe ushtrojnë veprimtari në Tiranë dhe Korçë.


³⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Zbatimin e Dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=13683>

Grafiku 2: Të ardhurat vjetore të OJF-ve (nr.=121 NPOs)



Përsa i përket përfitimeve tatimore 69% e OJF-ve raportuan se nuk përfituan asnjë lehtësi tatimore, ndërsa 18% deklaruan se nuk ishin në dijeni për ekzistencën e tyre. Vetëm dy organizata raportuan përfitim të rimbursimit të TVSH-së për grantet e huaja, dhe asnjë nga organizatat nuk kishin përfituar lehtësi tatimore për aktivitetin ekonomik.

Grafiku 6: Përfitimet tatimore për OJF-të (nr. =121 OJF)



Investimi pasiv kuptohet dhe pranohet si koncept nga organet tatimore dhe e diferencojnë atë nga aktiviteti ekonomik i OJF-ve. Sipas vëzhgimit, 19% e OJF-ve kanë të ardhura nga investimet pasive.

2.1.2. Stimujt mbi dhurimet

Dhurimi në formë sponsorizimesh për OJF-të është i vetmi lloj dhurimi i njohur dhe i rregulluar nga Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar⁴⁰. Ligji njih si shpenzim të zbritshëm fashat 3% deri në 5% të fitimit para tatimit (në varësi të llojit të aktiviteteve të sponsorizuara) nga subjektet që kualifikohen si tregtarë, qofshin persona fizikë, juridikë, vendas, të huaj apo ndërmarrje të përbashkëta. Megjithatë, lista e aktiviteteve të zbritshme përfshin vetëm ato që janë humanitare, kulturore apo artistike, si dhe organizatat që fokusohen në sport, arsim, mjedis, vepra letrare dhe aktivitete shkencore e kërkimore, duke përjashtuar demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Dhurimet individuale nuk njihen nga ligji. Dhurimet në natyrë dhe dhuratat e dhëna nga korporatat nuk janë shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore. Sponsorizimet e bëra për klubet sportive nga personat juridikë me fitim mbi 100 milionë lekë (rreth 1 milion euro) përfitojnë shpenzime të zbritshme në vlerën tre herë më të madhe se sponsorizimi aktual. Për të përfituar nga zbritja tatimore, sponsori duhet të marrë Autorizimin për Sponsorizim të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas një procedure dhe një pakete dokumentesh të përcaktuara.

Sipas Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat, kur shpallet një gjendje emergjente për shkak të një fatkeqësie natyrore, çdo dhurim në të holla ose në pasuri të paluajtshme i nënshtrohet një zbritjeje prej 5% të fitimit para tatimit. Megjithatë, këto dhurime kualifikohen për zbritje vetëm kur transferohen në arkën e shtetit dhe jo tek OJF-të.

Në praktikë, nuk ka politika shtetërore që mbështesin bashkëpunimin ndër-sektorial midis OJF-ve dhe sektorit privat. Gjithashtu, nuk ka të dhëna zyrtare për dhuruesit privatë që kanë kërkuar zbritje tatimore për dhurimet e tyre gjatë vitit 2023. DPT-ja nuk ktheu përgjigje lidhur me pyetjen në këtë aspekt.

OJF-të trajtohen në mënyrë të barabartë sa i përket dhurimeve. Në vitin 2023, Partnerët Shqipëri identifikoi 104,158 dhurime nga individë dhe biznese përmes Monitorimit të Aktivitetit Filantropik në Media dhe Platforma Online⁴¹. Vlera totale e dhurimeve është afërsisht 12 milionë euro. Krahasuar me Raportin MM 2022, ka një rritje prej 40% në numrin e dhuruesve, ndërsa shuma totale e dhurimeve është trefishuar. Platformat e financimit kolektiv online vazhdojnë të jenë kanali kryesor i dhurimeve në vend.

⁴⁰ Fletore Zyrtare 19/1994, Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/1994/12/21/7892/128a6306-5e74-46eb-a264-fd065c3d1562;q=Ligj%20per%20sponsorizimet>

⁴¹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, (2024), “Philanthropy – Edicioni 7”, I disponueshëm në: https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2024/02/Revista_Philanthropy_Edicioni_7.pdf

2.2. Mbështetja e shtetit

2.2.1. Financimi publik

Sa i përket financimit publik, Ligji Nr. 10093/2009 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” është ligji kryesor që rregullon mbështetjen publike. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) shërben si mekanizmi kryesor në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OJF-të, mandatuar të mbështesë zhvillimin e tyre institucional, projektet dhe bashkëfinancimin e granteve të BE-së apo granteve të tjera. Sipas Ligjit Nr. 10093/2009, buxheti i Agjencisë përcaktohet si një zë i veçantë në buxhetin vjetor të shtetit dhe nuk mund të jetë më i vogël se ai i vitit të kaluar (Neni 16, pika 2). Ligji dhe rregulloret e AMSHC-së sigurojnë procedura të qarta për pjesëmarrjen e OJF-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik.

Gjithashtu, institucione të tjera publike ofruan fonde publike në formë grantesh për OJF-të gjatë vitit 2023. Më poshtë paraqitet një listë e agjencive shtetërore në nivel qendror dhe lokal që iu përgjigjën kërkesës për informacion të Partners Albania, si dhe fondet përkatëse të akorduara prej tyre. Vlen të theksohet se fondet e administruara nga bashkitë burojnë si nga buxhetet e tyre, ashtu edhe nga donatorët e huaj, megjithëse përcaktimi i saktë i përqindjes për secilin burim është i vështirë të identifikohet.

Tabela 1: Financimi public nga institucionet publike ne nivel qendror

Institucionet	Numri i thirrjeve për projekt propozime	Numri total i aplikimeve të dorëzuara	Numri i OJF-ve fituese	Shuma minimale dhe maksimale për grante	Shuma totale e shpërndarë gjatë vitit 2023
AMSHC	1	141	65	Maks.: 2 million Lekë (përaf. 20,000 Euro)	98 million Lekë (përaf. 980,000 Euro)
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	N/A	8	N/A	45,399,450 Lekë (përaf. 450,000 Euro)
Ministria e Kulturës	1	231	186	Min.: 200,000 Lekë (përaf. 1,700 Euro) Maks.: 3,200,000 Lekë (përaf. 27,000 Euro)	122,317,600 Lekë (përaf. 1 million Euro)
Ministria e Drejtësisë	1	N/A	2	Maks.: 1,600,000 Lekë [(përaf. 16,000 Euro); (20% e fondit total)]	8,000,000 Lekë (përaf. 80,000 Euro)
Agjencia Kombëtare e Rinisë ⁴²	1	N/A	10	Min: 1,500,000 Lekë (përaf. 15,000 EUR) Maks.: 3,000,000 Lekë (përaf. 30,000 Euro)	57,995,790 Lekë (përaf. 570,000 Euro)

42 Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Rinisë. I disponueshëm në: <https://rinia.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Projektet-fituese-te-thirrjes-se-3-per-organizatat.pdf>

Tabela 2: Financimi public nga institucionet publike ne nivel vendor

Bashkia	Numri i thirrjeve për projekt propozime	Numri total i aplikimeve të dorëzuara	Numri i OJF-ve fituese	Shuma minimale dhe maksimale për grante	Shuma totale e shpërndarë gjatë vitit 2023
Himarë	1	5	5	Min.: 1,800,000 Lekë (përaf. 18,000 EUR) Maks.: 3,000,000 Lekë (përaf. 30,000 Euro)	13,100,000 Lekë (përaf. 29,500 Euro)
Përmet	1	4	4	Min.: 990,000 Lekë (përaf. 9,900 Euro) Maks.: 2,000,000 Lekë (përaf. 20,000 Euro)	5,900,000 Lekë (përaf. 59,000 Euro)
Vau i Dejës	1	3	3	Min.: 290,000 Lekë (përaf. 2900 Euro) Maks.: 1,000,000 Lekë (përaf. 10,000 Euro)	1,500,000 Lekë (përaf. 15,000 Euro)
Lezhë	1	12	1	Min.: 799,000 Lekë (approx. 79,000 Euro) Maks.: 1,000.000 Lekë (approx. 10, 000 Euro)	3,795,100 Lekë (approx. 37,000 Euro)
Tiranë	1	N/A	5	Min.: 1,000,000 Lekë (approx. 10,000 EUR) Maks.: 3,500,000 Lekë (approx. 35,000 EUR)	6,660,250 Lekë (approx. 66,000 Euro)
Maliq ⁴³	1	1	1	7,000,000 Lekë (approx. 70,000Euro)	7,000,000 Lekë (approx. 70,000 Euro)
Shkodër ⁴⁴	2	N/A	19	Min.:300,000 Lekë (approx. 3,000 Euro) Maks: 7,000,000 Lekë (approx. 70,000 Euro)	35,125,312 Lekë (approx.350,000 Euro)
Patos	1	15	2	N/A	1,617,000 Lekë (approx. 16,000 Euro)
Belsh	N/A	N/A	1	323,000 Lekë (approx. 3200 EUR)	323,000 Lekë (approx. 3200 Euro)
Kamëz	1	20	2	Min.: 700,000 Lekë (approx.. 7,000 Euro) Maks.: 2,000,000 Lekë (approx. 20,000 Euro)	3,996,968 Lekë (approx. 39,000 Euro)

AMSHC-ja zhvillon konsultime të përvitshme gjatë programimit të prioriteteve të financimit publik për OJF-të. Thirrja e vitit 2023 adresoi katër prioritete kryesore: shërbimet sociale dhe rinia; lufta kundër korrupsionit, edukimi ligjor publik dhe NSDI; mbrojtja e mjedisit; arsimit, integritimit evropian dhe hartimit të politikave. Bordi Mbikëqyrës i AMSHC-së përbëhet nga 9

⁴³ Bazuar në përgjigje, bashkia ka ofruar mbështetje në formë granti për ekipin e futbollit të qytetit.


⁴⁴ Bazuar në përgjigje, bashkia ka ofruar mbështetje në formë granti për ekipin e futbollit të qytetit.

anëtarë. Deri në publikimin e këtij raporti, katër anëtare janë përfaqësues të institucioneve qendrore të administratës publike, ndërsa 4 anëtare përfaqësojnë OJF-të⁴⁵.

Në praktikë, financimi publik i alokuar për OJF-të në buxhetin e shtetit përbën një kategori të veçantë. Shuma totale e shpërndarë për OJF-të është afërsisht në të njëjtin vlerë si vitin e kaluar.

26 nga 121 OJF të anketuara raportuan se kanë marrë mbështetje financiare dhe jo-financiare publike nga institucionet shtetërore. Sa i përket llojit të mbështetjes publike, 62% e OJF-ve raportuan se kanë marrë mbështetje financiare për grante për projekte ose aktivitete të veçanta. Vetëm një organizatë nga ky grup OJF-sh raportoi se ka marrë mbështetje institucionale nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. AMSHC-ja nuk ofroi mbështetje institucionale për OJF-të.

Grafiku 7: Mbështetja financiare publike për OJF-të (nr. =26 OJF)



2.2.2. Shpërndarja e fondeve publike

Në dhjetor 2023, Ministria e Drejtësisë nisi për konsultim publik “Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike”⁴⁶. Një nga objektivat në fushën e Shoqërisë Civile është krijimi i një kuadri ligjor, politik dhe institucional, në përputhje me instrumentet dhe standardet ndërkombëtare përkatëse, si dhe me strategjitë publike, për të promovuar hapësirën qytetare dhe për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për zbatimin dhe forcimin e kapaciteteve,

⁴⁵ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit e AMSHC-së. I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/bordim-bikqyres/>

⁴⁶ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të regjistrimit elektronik për konsultimet publike. I disponueshëm në: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/692>

funksionimit dhe performancës së OJF-ve, duke adresuar sfidat dhe mangësitë ekzistuese. Një nga rezultatet e pritshme është mbështetja e OJF-ve përmes financimit shtetëror, të lehtësuar nga procedura më të shpejta dhe të përmirësuara deri në vitin 2030, duke përfshirë: (i) përmirësimin e procedurave administrative në procesin e dhënies së granteve të AMSHC-së dhe (ii) funksionalitetin e plotë të platformës online për ndjekjen e procesit të granteve deri në vitin 2025.

Në bazë të Ligjit të AMSHC-në dhe rregullores për procedurat e financimit me grante në mbështetje të shoqërisë civile, AMSHC-ja siguron transparencë duke vënë në dispozicion të gjithë informacionin lidhur me procedurat e granteve. Njoftimi për procedurat është publik dhe ofrohet kohë e mjaftueshme (më shumë se 30 ditë) për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve të projekteve dhe dokumentacionit të kërkuar. Gjatë vitit 2023, AMSHC-ja organizoi seanca informimi në rajone të ndryshme të vendit, në mënyrë të rregullt dhe për çdo thirrje për propozime, për të shpjeguar procesin e aplikimit për financim, duke përfshirë kriteret e pranueshmërisë dhe të vlerësimit për OJF-të e interesuara⁴⁷.

Kriteret dhe metodologjia për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve nga AMSHC-ja përcaktohen në Rregulloren mbi Procedurat e Financimit, por nuk publikohen së bashku me thirrjen për propozime. Rregullorja e AMSHC-së përmban dispozita që përcaktojnë konfliktin e interesit⁴⁸.

Në lidhje me ministrinë e linjës, i gjithë procesi rregullohet përmes Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM), të cilat përcaktojnë fushat e mbështetjes, kriteret e përzgjedhjes, format e aplikimit, procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes, afatet për aplikim, çështjet e konfliktit të interesit, etj⁴⁹.

AMSHC-ja shpall fituesit e thirrjes për propozime në faqen e saj të internetit, duke përcaktuar emrin e organizatës, titullin e projektit, prioritetet e adresuara nga thirrja, zonën gjeografike të zbatimit, shumën totale të alokuar dhe afatin kohor të zbatimit të projektit⁵⁰.

Në praktikë, nga monitorimi i thirrjeve për propozime të publikuara nga AMSHC-ja në faqen e saj të internetit, disa dokumente, si NIPT-i dhe Marrëveshjet e Partneritetit (nëse nuk janë origjinale), duhet të jenë të noterizuara që aplikimi të jetë i pranueshëm. Nga vëzhgimi 65% e OJF-ve deklaruan se kriteret e aplikimit janë të qarta, ndërsa 58% ranë dakord që institucionet publike respektojnë procedurat e përcaktuara ligjërisht për alokimin e fondeve. Në lidhje me kërkesat e aplikimit, përvoja e OJF-ve ishte e ndarë: 42% i konsideruan ato të lehta, ndërsa 42% nuk ranë dakord. Po ashtu, 42% e OJF-ve deklaruan se përzgjedhja e fituesve ishte transparente.

⁴⁷ Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (2024), "Raporti Vjetor 2023". I disponueshëm në: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Raport-Vjetor-2023-AMSHC_compressed.pdf

⁴⁸ Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (2024), "Rregullore mbi Procedurat e Financimit me Grant në Mbështetje të Shoqërisë Civile". I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/RREGULLORE-mbi-procedurat-e-financimit-me-grant-ne-mbeshtetje-te-Shoqerise-Civile-Shkurt-2024-2.pdf>


⁴⁹ Për ilustrim, financimi publik nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit rregullohet përmes VKM Nr. 281, datë 13.04.2016, "Për përcaktimin e kriterëve dhe afateve për thirrjen për propozime për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit" (Fletorja Zyrtare, 69/2016).

Fondet nga Ministria e Drejtësisë rregullohen përmes VKM Nr. 110, datë 6.3.2019, "Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit dhe metodën e financimit". Në lidhje me fondet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, në korrik 2022, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr. 566, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave që punojnë me të rinjtë, të cilat përfitojnë nga skema e financimit me grante të dedikuar për të rinjtë nga buxheti i shtetit".

⁵⁰ Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, (2023), "Lista e Projekteve Fituese, Thirrja nr. 16". I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/lista-me-Ojf-te-fituese-Thirrja-nr.16-4.pdf>

Vlen të theksohet se ata që e konsideruan procesin transparent ishin kryesisht fitues të thirrjeve për propozime të shpallura nga Agjencia gjatë pesë viteve të fundit. Përsa i përket deklaratës së “vendimi për alokimin e fondeve ishte i drejtë”, 46% e OJF-ve të anketuara nuk ranë dakord.

Grafiku 8: Përvoja e OJF-ve në aplikimin për mbështetje publike (nr. 121 OJF)



2.2.3. Llogaridhënia mbi financimin publik

Në lidhje me transparencën e procedurave të financimit, procedurat e llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit përshkruhen qartë dhe në detaje në ligjin dhe rregulloren për procedurat e financimit me grante të AMSHC-së, duke mbështetur një proces transparent në të gjitha hapat e tij. Brenda Agjencisë funksionon edhe një departament përgjegjës për monitorimin e të gjitha projekteve të financuara nga Agjencia. Të gjithë përfituesit e fondeve publike janë të detyruar të dorëzojnë raporte të detajuara mbi përdorimin e fondeve të marra.

OJF-të që financohen nga fondet publike i nënshtrohen Ligjit Nr. 112/2015 “Për Inspektimin Financiar Publik”⁵¹, i cili synon të garantojë zbatimin e ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike kundër keqmenaxhimit financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës ose korrupsionit. OJF-të që kanë kryer pagesa në kundërshtim me ligjet në fuqi ose që kanë marrë angazhime përtej fondeve të parashikuara në buxhet mbajnë përgjegjësi për shlyerjen e detyrimit të krijuar.

⁵¹ Fletore Zyrtare 168/2015, Ligji Nr. 112/2015 “Për Inspektimin Financiar Publik”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/15/112>


Bazuar në informacionin e marrë, AMSHC-ja kryen monitorim të vazhdueshëm për projektet e financuara, duke përfshirë aspektet narrative dhe financiare. Por, raportet e monitorimit nuk bëhen publike.

Në lidhje me projektet për të rinjtë, neni 21 i VKM Nr. 566, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave që punojnë me të rinjtë, të cilat përfitojnë nga skema e financimit me grante të dedikuara për të rinjtë nga buxheti i shtetit”, përcakton rregulla të qarta për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e granteve në fushën e rinisë. Sipas pikës 3 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) duhet të kryejë një vlerësim vjetor të performancës së granteve në fushën e rinisë, i cili përfshin vlerësimin e menaxhimit të thirrjes për propozime, si dhe të rezultateve dhe ndikimit të arritur nga projektet e financuara.

Nga humultimi i faqes së internetit të AKR-së, nuk ka raporte vlerësimi publike. Informacioni mbi grantet e akorduara kufizohet në emrin e organizatës fituese, titullin e projektit dhe shumën e grantit të akorduar⁵².

Nga vëzhgimi me OJF, 62% nga 26 OJF-të që përfituan fonde publike raportuan të kenë qenë subjekt i monitorimit, 58% e tyre raportuan se monitorimi u krye sipas kriterëve të përcaktuara dhe vizitat monitoruese nga zyrtarët publik u njoftuan paraprakisht. Megjithatë, nuk ka asnjë raport të disponueshëm mbi impaktin e financimit publik.

Grafiku 9: Përvoja e OJF-ve mbi monitorimin publik të granteve (nr = 26 OJF)



2.2.4. Mbështetja Jofinanciare

Autoritetet publike ofrojnë mbështetje jofinanciare për OJF-të, duke vënë në dispozicion prona pa përfitim pagese, ofrimin e këshillimit dhe asistencës për ngritjen e kapaciteteve. OJF-të janë

⁵² Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë Kombëtare e Rinisë. I disponueshëm në: <https://rinia.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Projektet-fituese-te-thirrjes-se-3-per-organizatat.pdf>

ndër entitetet që mund të përfitojnë nga ripërdorimi i aseteve të konfiskuara, duke njohur vlerën e tyre si aktorë të rëndësishëm në adresimin e çështjeve sociale dhe zhvillimin e ekonomisë vendore.

Vendimi Nr. 632, datë 23.7.2010, "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrave dhe procedurave për dhënien në përdorim dhe tjetërsimin e aseteve të konfiskuara", në bazë të Ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, i mundësoi Agjencisë së Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK-së) dhënien në përdorim të aseteve të konfiskuara organizatave jofitimprurëse.

Institucionet publike të mëposhtme raportuan ofrimin e mbështetjes jofinanciare për OJF-të gjatë vitit 2023:

- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile organizoi një sërë aktivitete, takimesh dhe tryezash të rrumbullakëta me OJF-të në nivel kombëtar për çështje të ndryshme me interes të përbashkët, duke ofruar ambiente pa pagesë dhe duke siguruar letra reference për OJF-të.
- Ministria e Kulturës ka vënë në dispozicion ambientet e saj pa pagesë dhe ka ofruar ekspertizën e stafit të ministrisë për hartimin e projekteve, bazuar në kërkesat e OJF-ve.
- Në nivel vendor, vetëm 7 nga 45 bashki⁵³ që iu përgjigjën kërkesave të PA për informacion kanë ofruar mbështetje jofinanciare, e cila përbëhet nga ambiente me qira pa pagesë.
- Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka dhënë disa toka të konfiskuara për ripërdorim social nga OJF-të.

Vetëm pesë nga OJF-të që morën pjesë në vëzhgim raportuan se përfituan mbështetje jofinanciare nga institucionet publike dhe kërkesat ishin të lehta për t'u plotësuar. Këto organizata ushtrojnë veprimtari në fusha të tilla si ofrimi i shërbimeve sociale për grupet e marginalizuara, arti dhe kultura, si dhe integrimi i individëve në rrezik.

Ato organizata që përfitojnë nga mbështetja jo-financiare punojnë në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e marginalizuara, artin dhe kulturën, integrimin e njerëzve në rrezik etj.

⁵³Bashkia Kukës, Permet Tirana, Lezha, Shkodra, Shijak, Devoll


2.3. Kapitali njerëzor

2.3.1. Punësimi në OJF

Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë nuk ndryshoi gjatë vitit 2023. Sipas tij, OJF-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë. Sipas informacionit nga DPT-ja, janë 10,917 punonjës që punojnë në sektorin e OJF-ve për vitin 2023, nga të cilët 9,748 me kohë të plotë dhe 1,169 me kohë të pjeshme. Krahasuar me vitin e mëparshëm, vihet re një rënie e lehtë e numrit të punësuarve, e cila potencialisht lidhet me rënien e numrit të organizatave aktive gjatë vitit 2023. Përsa i përket programeve shtetërore të punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive⁵⁴ ofron programe të mbështetjes financiare për punëdhënësit, duke përfshirë OJF-të. Këto programe mbulojnë kryesisht subvencionet e pagave dhe sigurimin për 6-12 muaj për punëdhënësit që trajnojnë profesionalisht dhe/ose punësojnë të papunët.

Shumica e OJF-ve që morën pjesë në vëzhgimin e raportit të MM-së raportuan se kishin 1-5 punonjës me kohë të plotë (58%) dhe 1-5 punonjës me kohë të pjeshme (60%). Gjithashtu, 40% e OJF-ve raportuan se angazhojnë profesionistë të kontraktuar, si ekspertë dhe konsulentë. Lidhur me programet e qeverisë dhe përfitimet për stimulimin e OJF-ve, vetëm një OJF përzgjodhi këtë lloj mbështetjeje shtetërore. Ato organizata që raportuan më shumë se 30 punonjës me kohë të plotë ushtrojnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të fëmijëve apo të cilat mbështesin grupet e marginalizuara.

Grafiku 10: Punonjësit tek OJF-të (nr. = 121 OJF)



⁵⁴Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. I disponueshëm në: <https://www.puna.gov.al/mainMenu/punedhenes>

2.3.2. Vullnetarizmi në OJF


Vullnetarët janë pjesë shumë e rëndësishme e burimeve njerëzore tek OJF-të. Në vitin 2019, paketa ligjore për vullnetarizmin u plotësua me aktet ligjore të parashikuara në Lgjin Nr. 45/2016, rregullorja kryesore në fuqi për vullnetarizmin në Shqipëri që synon të rrisë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën shoqërore.

Nuk është bërë asnjë përparim në lidhje me ligjin për vullnetarizmin, pavarësisht se ai është renditur si masë në Politikën e Qeverisë drejt një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023. Pavarësisht synimit, Ligji paraqet një sërë paqartësish që kanë ndikuar negativisht në përfshirjen e vullnetarëve në OJF, siç janë raportuar në raportet e mëparshme të MM-së. Nuk ka strategji, apo programe kombëtare të vullnetarizmit nga shteti. Sipas draft dokumentit të “Udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike”, një kuadër ligjor i rishikuar për vullnetarizmin pritet të miratohet brenda vitit 2027.

Grupi i Punës, i krijuar në vitin 2022, me kërkesën e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Burimeve për Shoqërinë Civile që lehtësoi nismën, në partneritet me organizatën “Përtej Barrierave” dhe me pjesëmarrjen e OJF-ve të tjera dhe agjencive shtetërore u angazhuan në diskutime të shumta. OJF-të në bashkëpunim me ekspertë ligjorë dhanë komente dhe rekomandime për shumicën e artikujve, për të adresuar një gamë të gjerë sfidash dhe çështje komplekse që lidhen me ligjin. Një Grup Pune Ndërinstitucional pritet të krijohet në vitin 2024 për të punuar në përmirësimin e kuadrit ligjor mbi vullnetarizmin.

Sfidat e paraqitura nga kuadri ligjor reflektohen edhe në praktikë. Asnjë nga OJF-të e anketuara nuk raportoi se ka përfituar nga programet shtetërore të vullnetarizmit. Në vitin 2023, nga 121 OJF të anketuara, 102 OJF angazhojnë vullnetarë, por vetëm dy i regjistruan vullnetarët në DPT. Pothuajse gjysma e OJF-ve të anketuara (48%) raportuan se kishin angazhuar 1–10 vullnetarë. Organizatat me mbi 100 vullnetarë kryesisht punojnë në fusha të tilla si ndihma për individët e marginalizuar dhe ata me nevoja të veçanta, qëndrueshmëria dhe mbrojtja e mjedisit, shkenca, arsimit dhe mësimi gjatë gjithë jetës, mbrojtja sociale dhe të drejtat e fëmijëve, zhvillimi i të rinjve, shoqëria civile dhe vullnetarizmi.

Grafiku 3: Vullnetarët tek OJF-të (nr. = 121 OJF)



2.3.3. Angazhimi qytetar

Angazhimi qytetar është një temë që mësohet në institucionet e edukimit. Ajo është pjesë e kompetencave mësimore në lëndën “Edukata Qytetare”, e cila fokusohet në mësimin e nxënësve se si të bëhen qytetarë aktivë, të informuar dhe përgjegjës për veten dhe shoqërinë në tërësi. Përmes këtyre kompetencave, nxënësit zhvillojnë aftësi për të luajtur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar⁵⁵.

Më 20 maj 2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpalli listën e moduleve të akredituara për periudhën 2022–2026⁵⁶. Në këtë listë përfshihen një numër i gjerë trajnimesh në fushën e angazhimit qytetar, si përfshirja sociale, kultura demokratike në shkolla dhe komunitete, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, parandalimi i bullizmit, edukimi mediatik, aftësitë e buta, pjesëmarrja në komunitet, etj.

Gjithashtu, programet universitare përfshijnë mundësi ku studentët mund të marrin pjesë në praktika profesionale me OJF-të për një periudhë prej rreth tre muajsh. Gjatë kësaj kohe, ata angazhohen në aktivitete të ndryshme brenda organizatave.

⁵⁵ Slavkova, L., Kurilic, M. (2023), “Pritshmëri të Mëdha: Kërkesat dhe Realitetet e Edukimit Qytetar në Evropë”, *The Civic Innovation Hub*, 2023. I disponueshëm në: https://thecivics.eu/wp-content/uploads/2023/03/Mapping-CE-in-Europe_Documentation.pdf

⁵⁶ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. I disponueshëm në: <https://docs.google.com/spreadsheets/d/1HbB1xe1tUeOgDycOYf0C6UU8KC5nhp89/edit#gid=415799393>

Fusha 3: **Marrëdhënia Shtet-OJF**

3.1. Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

3.1.1. Strategjitë për bashkëpunim

Strategjia kryesore shtetërore për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile është Udhërrëfytyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023⁵⁷. Qëllimi i dokumentit është krijimi i instrumenteve dhe infrastrukturës institucionale për një dialog dhe bashkëpunim të institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile. Udhërrëfytyesi përfshin tre drejtime strategjike dhe nëntë fusha prioritare, të cilat marrin parasysh parimet dhe objektivat e përcaktuara në Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Udhërrëfytyesi dhe Plani i Veprimit parashikojnë masa/aktivitete për 3 drejtime strategjike: bashkëpunimi qeveritar i institucionalizuar - shoqëria civile në politikëbërje dhe integrim në BE; mundësimi i mjedisit ligjor dhe qeverisja e të dhënave; dhe mundësimi i kornizës fiskale dhe financimit.

Gjatë vitit 2023 nuk u evidentua asnjë përparim nga institucionet publike në lidhje me zbatimin e Udhërrëfytyesit dhe nuk u krye asnjë proces monitorimi me përfshirjen e shoqërisë civile. Vihet re një mungesë koordimi të politikave qendrore, mungesë të monitorimit dhe raportimit sistematik si dhe dialog të kufizuar me OJF-të. Ndërkohë, gjatë 2024 qeveria do të procesin e hartimit të një Udhërrëfytyesi për vitin 2024 – 2027.

Edhe pse Udhërrëfytyesi është dokumenti kryesor i politikave të qeverisë për krijimin e një mjedisi mundësues për OJF-të, 34% e OJF-ve të anketuara nuk janë në dijeni të ekzistencës së saj.

3.1.2. Mekanizmat për bashkëpunim

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), i themeluar në 2016, është një organ kolegjal këshillimor që synon të garantojë bashkëpunimin institucional ndërmjet shtetit dhe OJF-ve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë me pjesëmarrje dhe rritjes së transparencës nëpërmjet përfshirjes së qëllimshme të shoqërisë civile në këtë proces. Sipas përgjigjes së marrë nga AMSHC-ja, e cila shërben si sekretariat i KKSHC-së, në vitin 2023, KKSHC organizoi në prill Takimin Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe dy takime të KKSHC-së, respektivisht në qershor dhe nëntor.

Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile kishte për qëllim identifikimin e sfidave dhe ofrimin e rekomandimeve për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe përfshirjen e saj në strategjitë e zhvillimit në integrimin ekonomik, social dhe evropian, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Rreth 80 OJF morën pjesë në takim, duke dhënë një sërë rekomandimesh. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion publik për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga KKSHC-ja.

⁵⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.07.2019 "Për Aprovimin e Politikës së Qeverisë drejt një Mjedisi Më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023" i rishikuar. I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Udherrefytyesi-2019-rishikuar.pdf>


Në mbledhjen e qershorit, KKSHC-ja zyrtarizoi anëtarët e rinj nga shoqëria civile të zgjedhur në vitin 2023, diskutoi gjetjet e Takimit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe solli në vëmendje për konsiderim ndryshimin e ligjit për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që lidhen me lëndët narkotike. Ata gjithashtu rishikuan kalendarin për hartimin e Udhërrëfyesit të ri për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023.

Takimi i nëntorit shërbeu për prezantimin zyrtar të kryetares së re të KKSHC-së, e cila është gjithashtu ministrja e re e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe diskutimi i vizionit strategjik të KKSHC-së me ministrin. Që prej vitit 2020, AMSHC nuk publikon procesverbalet e mbledhjeve, as vijimin apo ecurinë e çështjeve të diskutuara.

Siç është theksuar në raportet e mëparshme të MM-së, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile vijon të përballet me sfida në përfaqësimin e prioriteteve të OJF-ve në proceset e politikëbërjes dhe funksionon në mënyrë të kufizuar. Ndryshimi i Ligjit për Këshillin Kombëtar për të reflektuar ndryshimet në portofolet ministrorë dhe përfaqësimin e tyre në Këshill mbetet prioritet. Sipas draft dokumentit të “Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, kuadri ligjor për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile pritet të ndryshohet në vitin 2026, me qëllim përmirësimin e funksionimit të tij dhe sigurimin e një përfshirjeje më të madhe të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Mosfunksionimi i Këshillit, së bashku me mungesën e lidhjes me mbështetësit, kanë çuar në një përqindje të konsiderueshme të OJF-ve të anketuara (41%) të cilat raportuan se nuk janë të informuara për punën e tij. Ndër OJF-të që ishin të informuara, 11% janë anëtarë të Këshillit. Një tjetër tregues i mosfunksionimit të Këshillit është numri i lartë i OJF-ve të anketuara (48%) që nuk morën pjesë në procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në Këshill, duke reflektuar jo vetëm mungesën e informacionit, por edhe mungesën e besimit për punën e tij. Kur u pyetën nëse vendimet e Këshillit bazohen në rekomandimet dhe kontributet e OJF-ve, 49% e OJF-ve të anketuara u përgjigjën: "Nuk e di."

Grafiku 4: Përvoja e OJF-ve rreth punës së KKShC (nr. = 121 OJF)




Një mekanizëm tjetër për bashkëpunim është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian. Në mars 2023, Ligji Nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së

Shqipërisë në Bashkimin Evropian” u ndryshua, duke i dhënë mundësi më shumë aktorëve të shoqërisë civile të marrin pjesë në këshill dhe në diskutimet e tij për kapitujt e integritimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi, kufizimi për të përfshirë vetëm 3 OJF për kapitull u abrogua, duke lënë hapësirë të gjithë aktorëve të interesuar të shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin e integritimit. Synimi ishte jo vetëm rritja e gjithëpërfshirjes së tij, por edhe niveli i ekspertizës së nevojshme për të përballuar procesin e monitorimit të negociatave dhe të gjitha dokumenteve që ky këshill do të monitorojë në këtë proces.

Në maj të vitit 2023 u shpall thirrja për anëtarësim nga OJF-të në Këshillin Kombëtar për Integrim Evropian. Si rezultat, u dorëzuan 16 aplikime nga shoqëria civile dhe të gjitha OJF-të që aplikuan, u anëtarësuan⁵⁸.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve, përsëri ekziston ende një nivel i ulët i ndërgjegjësimit të OJF-ve lidhur me këshillin dhe punën e tij, siç pasqyrohet në përgjigjet e OJF-ve të anketuara. 33% e tyre nuk janë të informuar për punën e këshillit, ndërsa më shumë se gjysma e tyre nuk e dinë nëse vendimet e këshillit janë bazuar në rekomandimet e OJF-ve apo që nuk kanë marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në këshill, respektivisht, 55% dhe 52%.

Grafiku 5: Përvoja e OJF-ve me punën e KKIE (nr. = 121 OJF)



⁵⁸ Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, (2024) "Raporti Vjetor 2023". I disponueshëm në: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404090950330886Raporti%20vjetor%20i%20KKIE%202023.pdf>

3.2. Përfshirja në procesin e politikave dhe vendimmarrjes

3.2.1. Standardet për përfshirjen e OJF-ve

Sipas Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, deri në vitin 2025, cilësia e konsultimeve, transparenca dhe pjesëmarrja publike e OJF-ve në proceset e vendimmarrjes do të përmirësohen. Kjo përfshin forcimin e kulturës pjesëmarrëse të publikut dhe palëve të interesit, si dhe rritjen e llogaridhënies së institucioneve në vendimmarrje përmes konsultimit publik, duke çuar në një kuadër rregullator më të mirë deri në vitin 2026. Gjithashtu, administrata publike duhet të jetë në gjendje të zbatojë procesin e konsultimit publik bazuar në standardet më të larta dhe të vazhdueshme.

Gjatë vitit 2023, grupi i punës për “Standardet dhe treguesit për një Parlament të Hapur” i cili u krijua në vitin 2021, vijoi konsultimet për përmirësimin e dokumentit të standardeve të transparencës me shoqërinë civile dhe median. Standardet pritet të miratohen në vitin 2024, por siç raportohet në Raportin e BE-së së vitit 2023 për Shqipërinë⁵⁹, “këto standarde sipas parimit të qeverisjes së hapur duhet ende të konsultohen, dakordësohen dhe miratohen”.

Sipas raportit “Pjesëmarrja e publikut dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse të Kuvendit për vitin 2023”⁶⁰, gjatë periudhës janar – dhjetor 2023, Komisionet e Përhershme Parlamentare kanë organizuar 347 mbledhje dhe 101 seanca dëgjimore. Publiku/OJF-të kanë propozuar 128 amendamente për projektligje, 44 prej të cilave janë miratuar nga komisionet, siç tregohet në Tabelën 3.

Tabela 1: Pjesëmarrja e komisioneve parlamentare dhe e shoqërisë civile në vitin 2023

Komisionet Parlamentare	Numri i Mbledhjeve	Numri i dëgjësave publike	Draft ligje	Amendamente të propozuara nga publiku/OJFtë	Amendamente të aprovuara nga publiku/OJFtë
Komisioni për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut	68	24	121	26	3
Komisioni për Punën, Çështjen Sociale dhe Shëndetësinë	17	4	27	0	0
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregitë dhe Mjedisin	32	8	75	0	0
Komisioni për Politikën e Jashtme	62	12	544	60	28
Komisioni për Sigurinë Kombëtare	29	13	163	0	0
Komisioni për Integrimin Evropian	45	12	286	9	9
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik	45	7	188	33	4
Komisioni për Ekonominë dhe Financat	49	21	216	0	0

⁵⁹ Komisioni Evropian, 2023, “Raporti për Shqipërinë 2023”. I disponueshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

⁶⁰ Kuvendi i Shqipërisë, 2023. “Raport për Pjesëmarrjen e Publikut dhe e Shoqërisë Civile në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2023”. I disponueshëm në:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202407011246120137RAPORT%20%20P%3%8BR%20P%3%8BMARRJEN%20E%20PUBLIKUT%20DHE%20T%3%8B%20SHOQ%3%8BRIS%3%8B%20CIVILE%20N%3%8B%20PROCESIN%20VENDIMMARR%3%8BS%20T%3%8B%20KUVENDIT%20P%3%8BR%20VITIN%202023.pdf>

Në vitin 2023, në regjistrin elektronik për konsultime publike janë publikuar 55 draft dokumente nga ministrinë e linjës, siç paraqiten në tabelën 4 më poshtë.

Tabela 2: Të dhënat nga regjistri elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik

Ministrinë	Konsultimet e publikuara 2023
Ministria e Arsimit dhe Sportit	2
Ministria e Financës	10
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	8
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1
Ministria e Brendshme	6
Ministria e Mbrojtjes	4
Ministria e Kulturës	1
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4
Ministria e Drejtësisë	6
Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	1
Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët	1

Një mekanizëm tjetër për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian është Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE)⁶¹, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në bordin drejtues të Platformës dhe 33 tavolina diskutimi dhe konsultimi⁶².

Bazuar në një intervistë të thelluar me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri, deri në fund të vitit 2023, u krijuan 26 tryeza diskutimi dhe konsultimi, 4 ishin në proces krijimi, dhe 3 ende nuk ishin krijuar. Pa krijimin e plotë të të gjitha 33 tryezave, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) nuk mund të funksionojë plotësisht, pasi Bordi Drejtues nuk mund të krijohet.

Platforma ende nuk ka arritur plotësisht qëllimin e saj të synuar për informimin, konsultimin, komunikimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave për anëtarësim në BE, duke rezultuar në nivele të ulëta angazhimi dhe pjesëmarrje të OJF-ve. Në platformë është e vështirë të gjendet informacion mbi progresin e arritur, pasi mungojnë përditësime në kohë. Siç

⁶¹ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian. I disponueshëm në: <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/en/strukturat/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/>


⁶² Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.749, datë.19.12.2019 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Strukturës Shtetërore Përgjegjëse për Zhvillimin e Negociatave dhe Përfundimin e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian". I disponueshëm në: <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/O-VKM-No.749-dt.19.12.2018-Krijimi-i-strukturave.pdf>

është theksuar në raportet e mëparshme të MM-së, monitorimi i faqeve zyrtare të ministrive të linjës tregoi se vetëm Ministria e Drejtësisë ofron informacion mbi tryezat, procesverbalet dhe pjesëmarrësit që kontribuojnë në diskutime. Gjithashtu, kjo është e vetmja ministri që iu përgjigj kërkesës për informacion mbi këtë temë për përgatitjen e Raportit të MM-së. Në maj të vitit 2023, Ministria e Drejtësisë publikoi një thirrje të hapur për shprehje interesi për të marrë pjesë në tavolina, dhe tre takime u organizuan më pas nga tryeza e diskutimit mbi Kapitullin 23, e cila përfshin përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJF-ve.

Në praktikë, nga vëzhgimi me OJF-të, 55% raportuan se janë përfshirë në konsultime për përgatitjen e projektligjeve dhe politikave gjatë vitit 2023, si Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Bujqësisë, Plani Kombëtar Antitrafik 2024-2025, Projektligji për Tatimin mbi të Ardhurat, projektligji për vullnetarizmin, përgatitjen e planeve sociale në nivel vendor, etj. Arsyet kryesore të organizatave që nuk janë përfshirë në proceset e konsultimit janë mungesa e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore, si dhe mungesa e informacionit, kurse për organizatat e reja, mungesa e pjesëmarrjes në rrjete është një nga arsyet e përmendura.

Për sa i përket masës në të cilën është marrë parasysh kontributi i OJF-ve gjatë konsultimit, 33% e OJF-ve të anketuara që kanë qenë pjesë e konsultimeve pohuan që janë marrë “disi në konsideratë”, ndërsa 36% e tyre pohuan që nuk e dinë nëse kontributi i tyre është marrë parasysh. Kjo reflekton një nga problemet kryesore të vazhdueshme në procesin e konsultimit, që është mungesa e kthimin të përgjigjes.

Grafiku 6: Shkalla e marrjes parasysh të kontributit të OJF-ve (nr. = 40 OJF).



Për sa i përket koordinatorit për shoqërinë civile, i vetmi institucion që ka një koordinatör për shoqërinë civile është Kuvendi i Shqipërisë dhe informacioni i kontaktit të tij është publik në faqen e Kuvendit.

Përsa i përket përvojës së OJF-ve në pjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimit, 40% e OJF-ve pohuan të jenë përfshirë në fazën e hershme të procesit të legjislativitetit dhe 44% e tyre pohuan se janë njoftuar për konsultimin të paktën një javë përpara.

3.2.2. Aksesimi në projektligjet

Në tetor 2023 u miratua Ligji Nr. 78/2023, i cili përditëson Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”⁶³. Ligji i ri sjell ndryshime në kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në monitorimin e zbatimit të ligjit. Ai përcakton qartë detyrimin për të publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare të autoritetit publik dhe pasqyruar datën e përditësimit të fundit. Gjithashtu, është ulur kufiri minimal për gjobat e vendosura ndaj zyrtarëve publikë që nuk u përgjigjen kërkesave për informacion. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, ulja e gjobave ndodhi për shkak se në shumë raste gjobat ishin disa herë më të mëdha se pagat e koordinatorëve për të drejtën e informimit⁶⁴.

Sipas raportit vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zyra e Komisionerit administroi 956 ankesa gjatë vitit 2023 dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 48 procedurave nga viti 2022, në total 1004 ankesa. Raporti theksoi një rënie të lehtë të numrit të ankesave gjatë dy viteve të fundit.

Sipas studimit të Res Publica mbi të drejtën e informimit, pati një përmirësim në cilësinë e përgjigjeve të dhëna nga institucionet publike. Megjithatë, pati dhe një ngadalësim të shpejtësisë së përgjigjeve, ku koha mesatare e përgjigjes ishte 23 ditë, shumë më e gjatë se afati ligjor prej 10 ditësh. Raporti theksoi se autoritetet publike nuk ndihen nën presion nga ligji për tu përgjigjur brenda afatit ligjor⁶⁵.


Në praktikë, vetëm 34% e OShC-ve të anketuara kanë ushtruar të drejtën e tyre për informim duke dërguar kërkesa për informacion te autoritetet publike. Nga këto, 56% raportuan se kanë marrë përgjigje brenda afatit të përcaktuar. Megjithatë, 49% deklaruan se përgjigja nuk adresoi në mënyrë të saktë kërkesën e tyre, dhe 59% nuk ranë dakord me pohimin se kërkesa e tyre është refuzuar me një shpjegim të qartë.

⁶³ Fletorja zyrtare 152/2023, Ligji Nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2023/09/21/78/5e7b1247-ef49-47b5-a8be-eb9281ac5498>

⁶⁴ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e Reporter.al. I disponueshëm në: <https://www.reporter.al/2022/10/24/ndryshimet-ne-ligjin-per-te-drejte-e-informimit-priten-me-kritika/>

⁶⁵ Res Publica, 2024, “E Drejta e informimit 2023”. I disponueshëm në: https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023_Web.pdf

Grafiku 7: Përvoja e OJF-ve lidhur me kërkesën për informacion (nr. = 34 OJF)



3.2.3. Organet ndërsektoriale

Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësues të OJF-ve në organet vendimmarrëse. Në bazë të përgjigjeve të marra nga institucionet publike, janë identifikuar disa organe ndërsektoriale, ku përfaqësohen OJF-të, si më poshtë:

- **Këshilli Koordinues për Çështjet e Mbrojtjes së Konsumatorit**, i cili analizon strategjitë dhe masat organizative për mbrojtjen e konsumatorëve në përputhje me ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar. Këshilli Koordinativ përbëhet nga përfaqësues të organeve të administratës shtetërore që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me mbrojtjen e interesit të konsumatorit, si dhe nga shoqatat jofitimprurëse të konsumatorëve dhe të biznesit. Katër anëtarë janë përfaqësues të OJF-ve.

- **Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar** është organ këshillimor i ministrit për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar, i krijuar në bazë të nenit 29 të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ai përbëhet nga 16 anëtarë, dhe një anëtar është nga sektori i OJF-ve. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar jep mendime për a) hartimin e strategjive, programeve kombëtare dhe akteve ligjore; b) projektbuxhetin për arsimin parauniversitar; c) çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e theksuar nga ministri.

- **Këshilli i Lartë i Sportit**, përfaqësuesit e të cilit caktohen me Urdhër Nr. 396 datë 08.07.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”. Tre anëtarë janë nga sektori i OJF-ve.

- Në fushën e bujqësisë, OJF-të përfshihen në grupet e punës për hartimin e bazës ligjore të institucionit. Kështu, për vitin 2023, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përfshirë OJF-të në: Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021-2027 (pjesë e grupit të punës); Ligji “Për vreshtin dhe verën” Ligji “Për bletarinë”; Ligji për “Grupet Lokale të Veprimit”.

3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

3.3.1. Angazhimi i OJF-ve në ofrimin e shërbimeve dhe procedurat e kontraktimit

Për ofrimin e shërbimeve dhe konkurrencën për kontratat shtetërore, Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”⁶⁶, i ndryshuar, prezantoi një kapitull të veçantë për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera të veçanta. Ndryshe nga Ligji i mëparshëm kur kriteri kryesor për dhënien e kontratës ishte çmimi më i ulët, neni 102 i ligjit përcakton se rregullat e tenderimit duhet të marrin në konsideratë një ofertë bazuar në cilësinë e shërbimeve, aksesueshmërinë, efektivitetin, koston, disponueshmërinë, dhe gjithëpërfshirje në shërbime, nevoja specifike për njerëzit në rrezik dhe grupe vulnerabël dhe inovacion. Neni 103 i tij parashikon që autoritetet publike i rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e tenderit organizatave të caktuara për shërbime për çështje shëndetësore, sociale dhe kulturore.

Në praktikë, Agjencia e Prokurimit Publik nuk shpalli tender për prokurimin social në vitin 2023, siç deklaroi dhe institucioni në përgjigjen e saj. Bazuar në vëzhgimin me OJF-të, 6 nga 121 OJF u përzgjedhën për kontratën publike për ofrimin e shërbimeve. Kjo kontratë kryhet nëpërmjet një transferte sektoriale të pakushtëzuar e cila sillet si një transferim destinacioni i përcaktuar për funksionet e reja, në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Njësitë Vetëqeverisje”.

Për sa i përket licencimit, sipas informacionit të marrë nga ministritë e linjës, janë 15 OJF të licencuara për të ofruar ndihmë juridike falas nga Ministria e Drejtësisë dhe 12 OJF të licencuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3.3.2. Financimi dhe monitorimi dhe vlerësimi për OJF-të – ofrues shërbimesh

Për vitin 2023 autoritetet publike të mëposhtme kanë kontraktuar shërbime për OJF-të:

Tabela 3. Kontraktimi i shërbimeve për OJF-të.

Institucionet	OJF-të fituese	Minimumi dhe maksimumi i financimit	Shuma totale e shërpndarë në 2023
Bashkia Korçë	2	Min.: 826,223 Lekë (përaf. 7,000 Euro) Max. 1,327,030 Lekë (përaf.11,000 Euro)	3,139,893 Lekë (përaf. 26,300 Euro)
Bashkia Shkodër	4	Min.: 50,000Euro (përaf. 420 EUR) Max.: 2,021,000 Lekë (përaf. 17,000 Euro)	4,128,000 Lekë (përaf. 34,700 Euro)
Bashkia Durrës	1	642,000 Lekë (përaf. 5,400 Euro)	642,000 Lekë (përaf. 5,400 Euro)

⁶⁶ Fletorja Zyrtare 30/2021, Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. I disponueshëm në : <https://qbz.gov.al/preview/aef29e14-849b-4f8c-9915-888c861bcb4f/cons/20240308>

Bashkia Dibër	1	960,000 Euro (përaf. 8,000 Euro)	960,000 Euro (përaf. 8,000 Euro)
----------------------	---	-------------------------------------	-------------------------------------

Autoritetet publike mund të ushtrojnë monitorim dhe vlerësim të ofrimit të shërbimeve si për sa i përket cilësisë së shërbimeve ashtu edhe shpenzimeve të financimit. Ato kanë të drejtë të inspektojnë ambientet në të cilat ofrohen shërbimet. Pas inspektimit, një raport përgatitet nga autoriteti inspektues dhe ndahet me ofruesin e shërbimit, duke përfshirë rekomandimet për përmirësime. OJF-të që morën pjesë në vëzhgim vlerësuan se kriteret e përcaktuara nga autoritetet shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike ishin të qarta, kontrolli mbi punën e organizatës që ofron shërbime me fonde publike nuk përbën barrierë dhe inspektimet kryhen në bazë të njoftimit paraprak nga inspektorët publik.

Bibliografia

Agjencia e Inteligjencës Financiare, 2024, “Vlerësimi Kombëtar i Riskut”, I disponueshëm në: https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Vleresimi_Kombetar_Riskut.pdf

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë, 2024, “Raporti Vjetor 2023”. I disponueshëm në: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Raport-Vjetor-2023-AMSHC_compressed.pdf

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë, 2024, “Rregullore mbi Procedurat e Financimit me Grant në Mbështetje të Shoqërisë Civile”. I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/RREGULLORE-mbi-procedurat-e-financimit-me-grant-ne-mbeshtetje-te-Shoqerise-Civile-Shkurt-2024-2.pdf>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Regullorja Nr. 58, datë 30.06.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike dhe Planit të saj të Veprimit 2020 – 2025” i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://amf.gov.al/readLaw.asp?id=211>

Banka e Shqipërisë, 2009, Regullorja 44/2019 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit”. I disponueshëm në: https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Nr_44_date_10_06_2009_Rregullorja_per_Parandalimin_e_Pastrimit_te_Parav_16278.pdf

Bino, B., 2022, “Treguesit mbi Nivelin e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022”. I disponueshëm në: <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2023/03/ALB-ENG-2022.pdf>

Departamenti Amerikan i Shtetit, 2023, “Raporti për të Drejtat e Njeriut - Shqipëria”, I disponueshëm në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2024/01/528267_ALBANIA-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf

Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i përditësuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>

Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8789>

Fletore Zyrtare 121/2021, Ligji Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, I përditësuar: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/80/852c9af6-f25b-492e-aa48-577ff8077583>

Fletore Zyrtare 5/2024, Gjykata Kushtetuese, Vendimi Nr. 60, datë 20.11.2023. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6>

Fletore Zyrtare 17/2022, Vendimi Nr. 35, datë 26.01.2022 “Për Krijimin dhe Vënien në Funkcion të Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse”. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/01/26/35/af554540-b05d-4ac0-bdbe-659c59b57f8c>

Fletore Zyrtare 113/2023, Vendimi Nr. 445, datë 24.07.2023 "Për miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse". I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/07/24/445/ccaaf377-4cb1-40b4-a874-162c12a07340>

Fletore Zyrtare 171/2015, Urdhër Nr. 62, datë 17.09.2015 "Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse dhe zbatimimi i tij i detyrueshëm". I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2015/09/17/62/23a3bc4c-b8ef-4c4c-82db-abb156fe36bd>

Fletore Zyrtare 83/2008, Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/05/19/9917/bb9b5ab1-5309-45e0-87c7-aab63d0937ae>

Fletore Zyrtare 23/2001, Ligji Nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për Tubimet". I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/04/23/8773>

Fletore Zyrtare 87/2021, Gjykata Kushtetuese Vendimi Nr. 24., datë 04.05.2021. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/04/24/ca2d2e4d-3fc2-46da-a852-29a63dbd5dc0>

Fletore Zyrtare 17/2023, Ligji Nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audivizive në Republikën e Shqipërisë". I disponueshëm në: <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Ligji-nr.-30-2023-Per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-ligjin-nr.-97-2013-Per-mediat-Audiovizive-ne-Republiken-e-Shqiperise-te-ndryshuar.pdf>

Fletore Zyrtare 197/2018, Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i Ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/197/c296680f-0015-4e9c-8bef-76fb6f7bb626>

Fletore Zyrtare 137/2023, Udhëzimi Nr. 27, datë 13.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime të Instruksionit Nr. 6, datë 30.01.2015, 'Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/137/c168f9e3-96bb-4897-9050-5e798bb527d9>

Fletore Zyrtare 19/1994, Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/1994/12/21/7892/128a6306-5e74-46eb-a264-fd065c3d1562;q=Ligj%20per%20sponsorizimet>

Fletore Zyrtare 168/2015, Ligji Nr. 112/2015 "Për Inspektimin Financiar Publik". I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/15/112>

Freedom House, 2023, "Raporti për 2023" I disponueshëm në: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2023>

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, 2019, "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse". I disponueshëm në: <https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20per%20OJF/SKK%20per%20OJF.pdf>

Këruti, K., 2024, "Nga Heshtja në Fuqi – Një përgjigje Rajonale për SLAPP në Ballkanin Perëndimor – Raporti për Shqipërinë". I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/from-silence-to-strength-a-regional-response-to-slapps-in-the-western-balkans/>

Kuvendi i Shqipërisë, 2024, "Raport për Pjesëmarrjen e Publikut dhe e Shoqërisë Civile në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2023". I disponueshëm në: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202407011246120137RAPORT%20%20OP%20C3%8B%20PJES%20C3%8B%20MARRJEN%20E%20PUBLIKUT%20DHE%20T%20C3%8B%20SHOQ%20C3%8B%20RIS%20C3%8B%20CIVILE%20N%20C3%8B%20PROCESIN%20VENDIMMARR%20C3%8B%20T%20C3%8B%20KUVENDIT%20P%20C3%8B%20VITIN%202023.pdf>

Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e përditësuar. I disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022, "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Monitorues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2021". I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-NPOs-development-country-report-for-albania-2021/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2024, "Letër e Partnerët Shqipëri drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi Vendimin nr. 445 "Për Miratimin e Formularëve Standard të Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse". I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/News/7085/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023, "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Monitorues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2022". I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2023/07/monitoring-matrix-report-2022.pdf>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021, "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Monitorues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2020". I disponueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2024, "Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri – Raport Vlerësimi", I disponueshëm në: <https://resourcecentre.al/2024-publication/capacity-and-needs-assessment-of-civil-society-organisations-in-albania/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2024, "Revista Philanthropy – Edicioni 7", I disponueshëm në: https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2024/02/Revista_Philanthropy_Edicioni_7.pdf

Qendra Kombëtare e Biznesit, 2024, "Raporti Vjetor për 2023". I disponueshëm në: <https://qkb.gov.al/media/38391/Raport%20Vjetor%20per%20Regjistrin%20Tregtar,%20Regjistrin%20e%20Leje,%20Licencave%20dhe%20Autorizimeve%20dhe%20Regjistrin%20e%20Pronarit%20Perfitues%202023.pdf>

Rrjeti i Kërkimeve për Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor, 2022, "Siguria Kibernetike dhe të Drejtat e Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Hartëzimi i Qeverisjes dhe Aktorëve", I disponueshëm në: <https://www.dcaf.ch/cybersecurity-and-human-rights-western-balkans-mapping-governance-and-actors>

Slavkova. L., Kurilic, M., 2023, "Pritshmëri të Mëdha: Kërkesat dhe Realitetet e Edukimit Qytetar në Evropë", Civic Innovation Hub, 2023. I disponueshëm në: https://thecivics.eu/wp-content/uploads/2023/03/Mapping-CE-in-Europe_Documentation.pdf

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike dhe Planit të saj të Veprimit 2020 – 2025”. I disponueshëm në: <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/National-Cybersecurity-Strategy-and-its-Action-Plan-2020-2025.pdf>

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Implementimin e Dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm në: <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=13683>

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.7.2019 “Për Miratimin e Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023, i rishikuar”. I disponueshëm në: <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Udherrefyesi-2019-rishikuar.pdf>


Anekset

Shënime mbi Metodologjinë

Që nga fillimi i ciklit të monitorimit në vitin 2013, Partnerët Shqipëri synoi një proces gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje gjatë kryerjes së hulumtimit për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit, duke prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të madh përfaqësuesish OJF-sh në të gjithë vendin. Këtë vit vëzhgimi për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit u krye në 25 qytete dhe anketimit iu përgjigjën 121 OJF. Pyetësi u administrua online përmes Microsoft Forms dhe u realizua me drejtorë ekzekutivë dhe menaxherë të nivelit të lartë të OJF-ve.


Vëzhgimi u krye në 12 Qarqe. Përzgjedhja e mostrës u bazua në numrin e OJF-ve të vendosura në çdo qytet dhe vullnetit të organizatave për të marrë pjesë në anketë. Grafiku 16 paraqet shpërndarjen gjeografike të organizatave pjesëmarrëse. Shumica e OJF-ve janë të vendosura në Tiranë.

Grafiku 8: Shpërndarja gjeografike e OJF-ve të anketuara (nr. = 121 OJF)




Sa i përket formës ligjore të regjistrimit, kampioni përbëhet nga 50% shoqata, 35% qendra, 13% fondacione dhe 2% grupe informale, siç tregohet në grafikun 17.

Grafiku 9: Forma ligjore e OJF-ve të anketuara (nr.=121 OJF)



Bazuar në përgjigjet në lidhje me fushën kryesore të punës së OJF-ve të anketuara, 12% punojnë në asistencë për grupet e marginalizuara dhe 12% për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e mjedisit. Kjo pasohet nga 11% që punojnë në demokraci, qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit, siç tregohet në grafikun 18.

Grafiku 10: Fusha kryesore të veprimtarisë së OJF-ve të anketuara. (nr. = 121 OJF, pyetje me shumë alternativa)



Pyetësi u pasua nga intervista të thelluara për të eksploruar çështje kontradiktore ose fusha ku nevojitej më shumë informacion për analizë.

Duke marrë parasysh sfidën me disponueshmërinë e të dhënave zyrtare për sektorin dhe bazuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Partnerët Shqipëri u dërgoi kërkesa për informacion institucioneve publike, në linjë me fushat e Matricës së Monitorimit.

